


Agjenda 2030 në Kosovë: Zhvillimi Ekonomik, Çështjet Sociale, Infrastruktura, Inovacioni, Mjedisi, Qeverisja dhe Bashkëpunimi



Përgatitur nga: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Autorët:

Burim Ejupi

Dardan Abazi

Valon Avdiu

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë qëndrime personale të autorëve dhe jodomosdoshmërisht prezantojnë qëndrimin e Fondacionit Konrad Adenauer.

Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung

Zyra në Kosovë

Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6

KO-10000, Prishtina

Telefoni +381 (0) 38 229 874

Prishtina@kas.de

www.kas.de/kosovo

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) është institut kërkimor dhe qendër e avokimit që ofron zgjidhje strategjike për politika publike, bazuar në hulumtime të pavarura. Themeluar më 2011 si një shoqatë e analistëve të politikave, hulumtuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, INDEP fokusohet në politikat zhvillimore, duke ofruar një vizion përmbajtësor për integritet Euro-Atlantike. Në Kosovë, ku edhe vepron, INDEP ka në fokus të veçantë forcimin e qeverisjes demokratike dhe luan rolin e mbikëqyrësit të politikave publike.

Përmbajtja

1. Hyrje: Agjenda 2030 në Kosovë	4
2. Metodologjia	6
3. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe zbatimi i OZhQ-ve në Kosovë	8
3.1. Korniza sipas OKB-së	8
4. OZhQ-të në fushën e zhvillimit ekonomik	13
4.1. OZhQ 1 – Pa varfëri	15
4.2. OZhQ 2 – Zero uri	18
Nuk ka të dhëna për asnjë tregues për këtë objektivi!	18
4.3. OZhQ 8 – Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike	19
4.4. OZhQ 12 – Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm	23
5. OZhQ-të në fushën e çështjeve sociale	25
5.1 OZhQ 3 – Shëndet i mirë dhe mirëqenie	27
5.2 OZhQ 4 – Arsim cilësor	32
5.3 OZhQ 5 – Barazi gjinore	36
5.4 OZhQ 10 – Zvogëlim i pabarazive	40
Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 10 tregues në objektivin 10!	40
6. OZhQ-të në fushën e zhvillimit të infrastrukturës dhe inovacionit	46
6.1 OZhQ 6 – Ujë i pastër dhe kanalizime	48
6.2 OZhQ 7 – Energji e përbalueshme dhe e pastërt	50
6.3 OZhQ 9 – Industri, inovacion dhe infrastrukturë	52
Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 9 tregues në objektivin 9.	52
6.4 OZhQ 11 – Qytete dhe komunitete të qëndrueshme	55
7. OZhQ-të në fushën e mjedisit	59
7.1 OZhQ 13 – Veprim për klimën	61
7.2 OZhQ 15 – Jeta nën ujë	62
7.3 OZhQ 15 – Jeta në Tokë	63
8. OZhQ-të në fushën e qeverisjes dhe bashkëpunimit	66
8.1 OZhQ 16 – Paqe, drejtësi dhe institucione të forta	67
8.2 OZhQ 17 – Partneritet për objektivat	70
9. Përfundimet	74
10. Rekomandime	75

1. Hyrje: Agjenda 2030 në Kosovë

Zhvillimi i qëndrueshëm është mjaft i rëndësishëm për të gjitha vendet, pa marrë parasysh stadin e tyre të zhvillimit. Si prioritet i vendosur në Traktatet Evropiane, zhvillimi i qëndrueshëm luan rol të veçantë në politikat evropiane. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm shërben si udhërrëfyes për të gjitha vendet drejt arritjes së një zhvillimi të qëndrueshëm socio-ekonomik. Kjo agjendë përfshirën 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ).

Në shtator të vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën "Transformimi i botës: Agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm". Kjo agjendë është një plan veprimi për njerëzit, planetin dhe prosperitetin. Për më tepër, ajo përfshin edhe vendosjen e një niveli sa më të mirë për paqen dhe partneritetin në botë. Agjenda 2030 gjithsej ka 17 objektiva, 169 qëllime dhe 231 tregues unik.

Duke synuar që objektivat dhe treguesit të monitorohen me standarde të njëjta nga të gjitha vendet e botës është zhvilluar korniza globale e treguesve nga Agjencia dhe Grupi i Ekspertëve mbi Treguesit e OZhQ-ve (IAEA-SDG) në bashkëpunim me Komisionin Statistikor të Kombeve të Bashkuara. Kjo kornizë dhe tregues janë miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social dhe Asambleja e Përgjithshme. Pas mbledhjes së të dhënave nga monitorimi dhe analizimi i tyre, vendet përpilojnë raporte vjetore të cilat prezantohen në takimet vjetore të Forumit të Nivelit të Lartë Politik mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm në OKB. Kosova ende nuk ka filluar procesin e përgatitjes së një raporti zyrtar vjetor të monitorimit të OZhQ-ve.

OZhQ-të nuk janë ligjërisht të detyrueshme, megjithatë, vendet priten të marrin pronësinë dhe të krijojnë një kornizë kombëtare për arritjen e tyre. Për matjen dhe monitorimin e progresit në zbatimin e OZhQ-ve deri në vitin 2030, të gjitha vendet, e në këtë rast edhe Kosova ka përgjegjësinë kryesore për të filluar monitorimin dhe rishikimin në nivel kombëtar. Fatkeqësisht, në Kosovë ende nuk ka një kornizë të tillë dhe përpjekjet për ta ndërtuar atë janë në një fazë të hershme. Politikat, planet dhe programet e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë janë baza e kësaj kornize. Monitorimi i zbatimit të OZhQ-ve në Kosovë kërkon të dhëna cilësore, të qasshme dhe të përditësuara. Për ta arritur një zbatim sa më të lartë dhe që askush të mos të lihet prapa, është e rëndësishme që të gjitha palët të jenë të përfshira në këtë proces përfshirë Kuvendin, Qeverinë, sektorin privat dhe shoqërinë civile.

Duke pasur parasysh që Kosova ende nuk ka raport zyrtar për monitorimin e OZhQ-ve, kjo tregon që deri më tani Kosova ka bërë shumë pak në integrimin e objektivave dhe treguesve në strategji kombëtare dhe sektoriale. Në këtë drejtim, një zhvillim pozitiv ishte miratimi i Rezolutës për OZhQ-të në vitin 2018 nga Kuvendi i Kosovës. Për më tepër, Kosova ka zhvilluar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (2016-2021), por nuk përmendet në mënyre eksplicite harmonizimi ose integrimi i treguesve të OZhQ-ve në këtë strategji.

Ky punim është bazuar në kornizën globale të treguesve dhe ka përdorur të dhëna zyrtare për monitorimin e progresit mbi objektivat dhe treguesit. Ky punim nxjerrë në pah nivelin e monitorimit dhe zbatimit të OZhQ-ve në Kosovë duke përfshirë sfidat për sigurimin e të dhënave cilësore dhe të përditësuara. Pjesa kryesore paraqet progresin që Kosova ka bërë drejt arritjes së OZhQ-ve sipas treguesve në 5 fusha, konkretisht në atë të zhvillimit ekonomik (OZhQ 1, 2, 8, 12), çështjet sociale (OZhQ 3, 4, 5, 10), zhvillimi i infrastrukturës dhe inovacioni (OZhQ 6, 7, 9, 11), çështjet e mjedisit (OZhQ 13, 14, 15) dhe qeverisja dhe bashkëpunimi (OZhQ 16 dhe 17). Kjo pjesë paraqet një pasqyrë statistikore me të dhënat e fundit për treguesit e OZhQ-ve në Kosovë (për disa vite mungojnë të dhënat).

2. Metodologjia

Ky raport ka kombinuar metodat kërkimore cilësore dhe sasiore përmes përdorimit dhe analizimit të të dhënave zyrtare, si raporte, publikime për OZhQ-të në Kosovë dhe analiza të të dhënave statistike të mbledhura direkt nga institucionet publike relevante. Gjetjet, analizat dhe rekomandimet janë mbështetur në praktikën më të mirë të vendeve udhëheqëse në zbatimin e OZhQ-ve.

Të dhënat e përdorura në këtë punim janë mbledhur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe mbulojnë periudhën 10 vjeçare më saktësisht për vitet 2010-2019. Duke pasur parasysh që të dhënat nuk janë lehtë të qasshme dhe në dispozicion dhe nuk janë të klasifikuara siç kërkohen nga treguesit e OZhQ-ve, kjo ishte një sfidë për përpilimin e këtij punimi. Të dhënat kryesisht janë siguruar nga ASK, Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT), Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Agjencia për Barazi Gjinore (AGE). Për këtë punim janë përdorur vetëm të dhëna zyr-

tare vendore për secilin indikator, ndërsa për të analizuar ato punimi i është referuar raporteve vendore dhe ndërkombëtare.

Gjetjet kryesore nga monitorimi i OZhQ-ve janë përpiluar në tabelat përkatëse. Të dhënat në tabelat e mëposhtme janë konsideruar të disponueshme vetëm nëse kanë qenë në harmoni me parimet e Kombeve të bashkuara ku definohen konceptet dhe definicionet, metodologjia (kalkulimi, disagregimi, trajtimi i vlerave që mungojnë), burimi i të dhënave, disponueshmëria e të dhënave dhe kalendari i mbledhjeve dhe publikimit të të dhënave. Rekomandimet konkrete të listuara në fund të punimit, konkretisht në pjesën e përfundimit dhe rekomandimeve, janë mjaft të rëndësishme në përmirësimin e mbledhjes së të dhënave, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë në zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve në Kosovë.

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe zbatimi i OZhQ-ve në Kosovë

3

3. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe zbatimi i OZhQ-ve në Kosovë

3.1. Korniza sipas OKB-së

Agjenda 2030 ka 17 objektiva, 169 qëllime dhe 232 tregues unik. Treguesit ndahen dhe klasifikohen në 3 nivele¹

Niveli i parë (Tier 1) përfshin 116 tregues konceptualisht të qartë që kanë një metodologji të krijuar dhe standardet e të cilëve janë në dispozicion. Nga çdo vend të dhënat mbledhen në baza të rregullta për të paktën 50% të vendbanimeve dhe të popullsisë për tregues të rëndësishëm në atë rajon.

Niveli i dytë (Tier 2) përfshin 92 tregues konceptualisht të qartë që kanë një metodologji të krijuar dhe standardet e të cilëve janë në dispozicion, por të dhënat nuk mbledhen rregullisht nga shtetet.

Niveli i tretë (Tier 3) përfshin 20 tregues për të cilët nuk ka metodologji apo standarde të krijuara, por ato janë duke u zhvilluar ose testuar.

Duhet sqaruar që numri i përgjithshëm i treguesve të listuar në kornizën globale të treguesve është 247. Mirëpo, pasi që 9 tregues përsërisin deri në 2 ose 3 objektiva të ndryshme, numri total i treguesve individualë në listë është 231². Secili nga këta tregues unik ka përshkrimin³ sesi duhet të kalkulohet dhe monitorohet. Ky përshkrim përfshin konceptet dhe definicionet, metodologjinë (kalkulimin, disagregimin dhe trajtimin e vlerave që mungojnë), burimin dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe kalendarin e mbledhjeve dhe publikimit të të dhënave.

1 Kombet e Bashkuara, 2020. Klasifikimi i treguesve në nivel global.

E qasshme në: <https://unstats.un.org/sdgs/iaeg-sdgs/tier-classification/>

2 Kombet e Bashkuara, 2020. Korniza e treguesve global për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe objektivat e Agjendës së vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

E qasshme në: <https://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/>

3 Kombet e Bashkuara, 2020. Databaza për Metadata.

E qasshme në: <https://unstats.un.org/sdgs/metadata/>

Për të vlerësuar nëse janë duke u zbatuar treguesit e OZhQ-ve, ky punim konsideron parimet e Kombeve të Bashkuara si më poshtë:

Konceptet dhe definicionet – cili është definicioni i saktë i atij treguesi që është duke u zbatuar në Kosovë dhe sesi bëhet matja e këtij treguesi. Duhet të dihet qëllimi i këtij treguesi dhe si kontribuon në atë sektor, p.sh. “një ndryshim pozitiv i përqindjes në BPV real vjetor për kokë banori mund të interpretohet si një rritje e standardit mesatar të jetesës së banorëve në një vend ose zonë”. Gjithashtu, duhet të dihen konceptet specifike, p.sh. çka nënkupton me Bruto Produktin Vendor (BPV). Kjo bëhet në mënyrë që treguesi të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare pasi që në disa vende mund të përdoren versione të ndryshme të Sistemit të Llogarive Kombëtare ose mund të përdoren parametra të ndryshëm në mbulimin e ekonomisë jo-formale për të matur BVP.

Metodologjia – duhet të shikohet mënyra e kalkulimit të treguesve që janë duke u zbatuar në Kosovë, p.sh. si të konvertohet BPV real në valutën vendore me çmimet e vitit 2010 ose mënyra e kalkulimit të BVP për kokë banori apo mënyra sesi kalkulohet rritja e BPV. Të shikohet nëse disagregimi i të dhënave bëhet sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit të migracionit, statusit të personave me aftësi të kufizuar dhe vendndodhjes gjeografike ose karakteristikave të tjera që kërkojnë treguesit specifik. Te parimi i metodologjisë është e rëndësishme edhe trajtimi i vlerave që mungojnë. Pra, kur të dhënat e plota nuk janë të disponueshme, një hierarki e burimeve të tjera të të dhënave përdoret për të mbledhur informacione. Të dhënat e mbledhura përdoren direkt ose zbatohen procedurat e vlerësimit për të marrë të dhënat e nevojshme.

Burimi i të dhënave – duhet të dihet burimi

i të dhënave dhe sesi mblidhen ato të dhëna, p.sh. përmes anketave specifike, të dhënave administrative apo regjistrimit të popullsisë, etj. Disa tregues mund të kenë burimin e të dhënave edhe nga ndonjë organizatë ndërkombëtare. Gjithashtu, duhet të shikohet procesi i mbledhjes së të dhënave dhe koha kur ato të dhëna janë mbledhur.

Disponueshmëria e të dhënave – këtu duhet të shikohet kush është përgjegjës për të publikuar të dhënat, si dhe cilat publikime kohore janë në dispozicion, p.sh. vjetore, tremujore dhe mujore.

Kalendari i mbledhjes dhe publikimit të të dhënave – është shumë e rëndësishme që për çdo tregues të dihet dhe definohet se kur fillon procesi i mbledhjes së të dhënave dhe kur përfundon ky proces. Për çdo tregues vendet kanë kohën për procesin dhe publikimin e të dhënave, p.sh. mbledhja për vlerësim zyrtar vjetor të llogarive kombëtare nga vendet që përdorin pyetësin e llogarive kombëtare fillon në shkurt të çdo viti për të dhënat e disponueshme për vitin paraprak.

3.2. Korniza institucionale në Kosovë

Kosova është në fillimin e zbatimit të OZhQ-ve, por ende nuk ka filluar monitorimin e tyre. Për të pasur një zbatim dhe monitorim sa më të mirë është e nevojshme përfshirja e të gjithë akterëve relevant.⁴ Në Kosovë integrimi i treguesve të OZhQ-ve është i panjohur pasi që ende nuk ka ndonjë raport zyrtar të monitorimit. Duke pasur parasysh që OZhQ-të përfshijnë një gamë fushash, të cilat janë komplekse dhe kërkojnë koordinim në nivel kombëtar, Qeveria është akteri kryesor që do të kontribuonte më së shumti në këtë drejtim. Megjithatë, në zbatim rol mjaft të rëndësishëm luajnë edhe organizatat, bizneset, qytetarët, ku të gjithë ndërmarrin veprime për çështjet që ndërlidhen me zhvillimin e

qëndrueshëm.

Më 25 janar 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për OZhQ-të. Qëllimi kryesor i kësaj rezolute është që Kosova të kontribuojë në zbatimin e OZhQ-ve duke miratuar legjislacion dhe monitoruar aktivitetet e Qeverisë, por fatkeqësisht ende nuk ka zhvillime konkrete përtej themelimit të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Ende nuk është vendosur baza ligjore sesi do të funksionojë ky Këshill dhe cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e tij për Zhvillim të Qëndrueshëm në kuadër të Rezolutës Nr. 06-R-001 mbi adoptimin e OZhQ-ve në Kosovë.

Kosova ende nuk ka një kornizë me treguesit relevant në të cilën mund të mbështet grumbullimin e të dhënave të vlefshme që mund të përdoren për matjen e progresit dhe raportimin e OZhQ-ve. Prandaj, zbatimi dhe monitorimi i OZhQ-ve në lidhje me aktivitetet e Qeverisë është një hap parësor.

Sa i përket ndërlidhjes së OZhQ-ve me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe sfidat për sigurimin e të dhënave, Kosova ka filluar përkushtimin për OZhQ-të dhe ka provuar që të kontribuojë në integrimin e kësaj agjende globale. Kjo filloi me një plan ambicioz për integrimin dhe zbatimin e OZhQ-ve përmes Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021/Plani për Zhvillim të Qëndrueshëm⁵. Kjo strategji adreson vetëm prioritetet e larta në Kosovë dhe nuk përmend integrimin apo zbatimin e OZhQ-ve. Kjo strategji ka 4 shtylla si fushat ku nevojitet më shumë ndërhyrje dhe qasje:

- 1) Kapitali njerëzor (me fokus punësimin dhe arsimin),
- 2) Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, veçanërisht për largimin e pengesave ligjore për funksionimin e ekonomisë së tre-

⁴ Hapat afatshkurtër dhe afatmesëm që duhet të ndërmerren nga Qeveria për zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve në Kosovë

https://indep.info/wp-content/uploads/2019/12/Kosovo-and-SDGs_Steps-Forward.pdf

⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës, 2016. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

E qasshme në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

gut,

3) Industrinë konkurruese (me fokus në rritjen e kapaciteteve konkurruese për ndërmarrjet kosovare),

4) Infrastrukturën (me fokus kryesisht në energji dhe infrastrukturë rrugore).

Treguesit e OZhQ-ve janë shumë specifik dhe kërkojnë ndërmarrje të aktiviteteve konkrete për adresimin e tyre, të cilat mungojnë në strategjinë e Kosovës. Edhe pse strategjia si nën titull ka qëndrueshmërinë, ajo nuk e bënë të qartë ndërlidhjen me qëllimet dhe treguesit e OZhQ-ve. Sipas INDEP6, 4 fushat e strategjisë adresojnë në mënyrë direkte ose indirekte 11 OZhQ nga gjithsej 16 OZhQ, të cilat janë relevante për Kosovën. Por, kjo nuk do të thotë që Kosova qëndron mirë në adresimin e OZhQ-ve, pasi që në këtë strategji adresohen një numër jashtëzakonisht i vogël i treguesve të këtyre 11 OZhQ-ve. Për më tepër, të dhënat për këta tregues nuk janë në dispozicion siç nënvizohet në strategji.

Në përgjithësi, strategjia ka dështuar të integrojë treguesit e OZhQ-ve duke mos konsideruar 2 faktorë kritikë. Së pari nuk është përdorur ndonjë metodë për të harmonizuar politikën e Kosovës me treguesit e OZhQ-ve. Për këtë do të mund të përdorej Vlerësimi i Shpejtë i Integruar⁷ i KB. Ky dokument përmban një udhëzues që ka për qëllim të mbështesë vendet në përfshirjen e OZhQ-ve në strategjitë e tyre kombëtare. Udhëzuesi sugjeron hapa dhe veprime të qarta për hartuesit e politikave për të kryer një Vlerësim të Shpejtë të Integruar (RIA) të OZhQ-ve për të përcaktuar rëndësinë e tyre në kontekstin e vendit, në nivelin kombëtar dhe ndërlidhjet midis objektivave. Ky vlerësim është hapi i parë në përcaktimin e një qasje strategjike për të

6 INDEP. 2019. Kosova dhe Agjenda 2030: Nga Retorika Politike në Veprime Konkrete.

E qasshme në: https://indep.info/wp-content/uploads/2019/07/SDG_ALB.pdf

7 Vlerësimi i Shpejtë i Integruar

E qasshme në: <https://www.undp.org/content/dam/undp/library/SDGs/RIA%20Tool%20-26.12.201-Final.pdf>

zbatuar OZhQ-të.

Së dyti, vendosja e prioriteteve ambicioze të zhvillimit kombëtar të Kosovës dhe zbatimi i OZhQ-ve deri në vitin 2030 do të kërkojë investime të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm. Strategjia duhet të ketë identifikimin e masave për të siguruar që kufizimet e burimeve financiare nuk bëhen pengesë për arritjen e objektivave të përcaktuara.

OZhQ-të në fushën e zhvillimit ekonomik

1 NO
POVERTY



2 ZERO
HUNGER



8 DECENT WORK AND
ECONOMIC GROWTH



12 RESPONSIBLE
CONSUMPTION
AND PRODUCTION



4

4. OZhQ-të në fushën e zhvillimit ekonomik

Fusha e zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmëria ekonomike janë shumë të rëndësishme në zbatimin e Agjendës 2030, pasi që mungesa e zhvillimit ekonomik ndikon negativisht në zbatimin e të gjitha objektivave tjera. Në përgjithësi, bota është në një fazë kritike duke pasur parasysh që shumë njerëz jetojnë në varfëri ekstreme (prej të cilëve gratë e përbëjnë shumicën), mungojnë skemat sociale, kequshqyerja është prezente, papunësia është lartë, ka punësim joformal, ka hendek të pagave mes gjinive, zvogëlimi i burimeve natyrore të nevojshme për të mbështetur mënyrën e jetesës aktuale, prishja dhe dëmtimi i ushqimeve dhe ndotja e lumenjve dhe liqeneve.⁸ Kosova ballafaqohet me sfida në fushën e zhvillimit ekonomik. Si shumë ekonomi të tjera të vogla, edhe ekonomia e Kosovës është e ndikuar nga zhvillimet dhe aktivitetet e jashtme ekonomike duke pasur parasysh që ajo përballlet me një bilanc tregtar negativ dhe ka mbështetje të lartë në remitanca. Prandaj, disa nga këto sfida t[evidencuara në vende tjera reflektohen edhe në Kosovë. Në vijim nënvizohen sfidat dhe të dhënat për secilin tregues në këtë fushë.

Bazuar në tabelën 2, në Kosovë, aktiviteti ekonomik është rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2015, por kjo rritje nuk është e mjaftueshme duke pasur parasysh që Kosova ka një bazë të ulët të industrisë së prodhimit dhe rritja ekonomike e saj është kryesisht e bazuar në konsum. Kjo më së miri dëshmohet nga papunësia shumë e lartë (sidomos te gratë), ku kjo përbën barriera për të përshpejtuar rritjen ekonomike dhe përmirësimin e kualitetit të jetës. Niveli i papunësisë në vitin 2019 ishte 25%. Sa i përket përqindjes së të rinjve (nga mosha 15-24 vjeç) që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim, ajo është rritur ndër vite. Për të argumentuar tutje që rritja ekonomike nuk është e mjaftueshme, duhet të shohim bilancin tregtar të vendit i cili është rritur ndër vite dhe tani qëndron në 43% të BPV-së. Gjithashtu, ndikimi në ekonomi do të vërehet edhe tek zvogëlimi i investimeve të huaja direkte.

Pandemia COVID-19 është shumë më tepër sesa një krizë shëndetësore, e cila ka prekur si shoqëritë ashtu dhe ekonomitë e tyre. Ndërsa ndikimi i pandemisë do të ketë efekte të ndryshme nga vendi në vend, ka shumë gjasa që kjo krizë të rrisë varfërinë dhe pabarazitë në nivel global, duke e bërë arritjen e OZhQ-ve edhe më urgjente. Prandaj për të adresuar të gjitha këto sfida është shumë e rëndësishme ofrimi i perspektives për qytetarët e Kosovës, të ketë një stabilitet ekonomik, dhe të ketë një model të qëndrueshëm të konsumit dhe prodhimit.

Zhvillimi ekonomik adresohet nga 4 objektiva në Agjendën 2030, të cilat janë:

Objektiva 1: Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj,

Objektiva 2: Zero uri, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimin të të ushqyerit si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme (për të cilën nuk ka të dhëna),

Objektiva 8: Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë,

Objektiva 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit (për të cilën nuk ka të dhëna).

Në vijim janë të dhënat statistikore në dispozicion për treguesit që bien mbi secilën nga këto 4 objektiva të cilat adresojnë zhvillimin ekonomik në Kosovë.

⁸ Kombet e Bashkuara, 2020. Why SDGs Matter?

E qasshme në: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/why-the-sdgs-matter/>

Tabela 1: Disponueshmëria e treguesve global në Kosovë në fushën e zhvillimit ekonomik

Zhvillimi Ekonomik	Numri i qëllimeve	Numri i treguesve	Tregues të disponueshëm sipas parimeve të Kombeve të Bashkuara	Tregues jo të disponueshëm
OZhQ 1 – PA VARFËRI	7	14	4	10
OZhQ 2 – ZERO URI	8	13	0	13
OZhQ 8 – PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE	12	17	6	11
OZhQ 12 – KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM	11	13	0	13
Total	38	57	10	47

Objektiva 1 në Agjendën 2030 ka gjithsej 7 qëllime dhe 14 tregues. Kjo objektivë ka të dhëna në dispozicion vetëm për 4 tregues. Objektiva 2 ka gjithsej 8 qëllime dhe 13 tregues, nga të cilat nuk ka të dhëna në dispozicion për asnjë tregues. Objektiva 8 ka gjithsej 12 qëllime dhe 17 tregues, ndërsa në Kosovë ka të dhëna në dispozicion vetëm për 6 tregues. Objektiva 12 ka gjithsej 11 qëllime dhe 13 tregues, nga të cilat nuk ka të dhëna në dispozicion për asnjë tregues.



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 10 tregues në Objektivin 1.

4.1. OZhQ 1 – Pa varfëri

Ky është objektivi 1 në Agjendën 2030 i cili gjithsej ka 7 qëllime dhe 14 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, ka të dhëna në dispozicion vetëm për 4 tregues nga gjithsej 14 sa janë për këtë objektive.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë nga të gjitha vendet që të zhduket varfëria ekstreme duke përgjysmuar përqindjen e njerëzve që jetojnë në varfëri dhe të zbatohen skemat sociale për njerëzit e varfër dhe të pambrojtur. Për më tepër, t[gjith[burrat dhe grat[, e sidomos njer[zit e varf[r dhe t[pambrojtur, duhet të kenë të drejta të barabarta në përdorimin e burimeve ekonomike dhe duhet krijuar korniza të shëndosha të politikave në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Për 10 tregues të tjerë të këtij objektivi nuk ka të dhëna, prandaj zbatimi dhe monitorimi i saj është i mangët. Në kuadër të këtij objektivi, mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme, si psh. për të drejtat e barabarta për burrat dhe gratë, në veçanti për grupin e prekur nga varfëria dhe të pambrojturit në përdorimin e resurseve ekonomike, siç janë qasja në shërbimet minimale, pronësi mbi tokën, trashëgimi, burimeve natyrore, shërbimeve financiare, përfshirë dhe mikrofinancat. Mungojnë të dhëna rreth përqindjes së shpenzimeve të përsëritura dhe kapitale të Qeverisë në sektorët që në mënyrë disproporcionale përfitojnë gratë, grupet e varfra dhe të cenueshme. Nuk ka të dhëna për përqindjet e resurseve të alokuara nga Qeveria drejtpërdrejt në programet e uljes së varfërisë.

Tabela 2: OZhQ 1 – Pa varfëri

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë kombëtare, sipas gjinisë dhe grupmoshës ⁹	23.7	17.8	21.5	17.6	16.8	18
1.2.1.a Sipas gjinisë										
Grua	24.1	18.1	22.2	18.1	17.2	18.9
Burrë	23.3	17.4	20.7	17.1	16.5	17.2
1.2.2 Përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e saj sipas përcaktimeve kombëtare ¹⁰	27.3	20.4	25.7	20.8	21.1	22.8
1.3.1 Përqindja e popullsisë e mbuluar nga sistemet e mbrojtjes sociale ¹¹ Tregues i përfaqësues: Përqindja e shpenzimeve të Qeverisë për mbrojtje sociale	13.2	12.7	13.7	14.6	17.7	21.4	23.1	23	24	25.75
1.a.2 Përqindja e shpenzimeve totale të Qeverisë për shërbime esenciale (arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale) ¹²	35.4	35.7	36.3	37.6	39.0	44.9	47.3	47.0		

Bazuar në të dhënat në dispozicion, në Kosovë përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë kombëtare në vitin 2017 ka qenë 18%. Kjo do të thotë se 18% e shoqërisë kanë pasur mundësi monetare për vetëm një shportë të konsumit minimal, e cila përfshin sasinë e mallrave dhe shërbimeve të cilat përbushin nevojat bazike për jetesë. Duke krahasuar këtë shifër me vitet 2016 dhe 2015, fatkeqësisht, shohim një rritje të varfërisë në Kosovë. Nëse krahasojmë varfërinë sipas gjinisë, nga tabela 1 mund të vërehet se nga viti 2012 deri 2017, niveli i varfërisë te gratë ka qenë më i lartë sesa te burrat me një mesatare

9 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës
<https://ask.rks-gov.net/media/4882/statistikat-e-varf%C3%ABris%C3%AB-2012-2017.pdf>

10 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës
 E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/4882/statistikat-e-varf%C3%ABris%C3%AB-2012-2017.pdf>

11 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Llogaritë Qeveritare
 E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-qeveritare>


12 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017. Llogaritë Qeveritare 2010-2017
 E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-qeveritare>

prej 1%. Këto të dhëna të varfërisë kombëtare janë të rëndësishme dhe shërbejnë për të hartuar politika që zvogëlojnë apo zhdukin këtë fenomen.

Treguesi 1.2.2 përfshin shkallën e varfërisë për fëmijët nga mosha 0-18 vjeç. Siç mund të shihet në tabelën 1, fëmijët kanë më shumë gjasa se të tjerët të jenë të varfër. Në vitin 2017, shkalla e përgjithshme e varfërisë të fëmijët ishte 22.8%, 4.8% më e lartë se shkalla e varfërisë së popullsisë së përgjithshme. Nga viti 2012 deri në vitin 2017, shkalla e varfërisë të fëmijët kishte ra për 4.5%, që paraqet një rënie më të ulët krahasuar me uljen e varfërisë për popullsinë e përgjithshme 5.7%. Qëllimi i këtij objekti është që të zvogëlohet të paktën përgjysmë përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri. Por, siç mund të shihet në tabelën e mësipërme, ritmi i nivelit të zvogëlimit të varfërisë është shumë i ngadalshëm dhe kjo do të ketë ndikime afatgjatë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në Kosovë.

Grafiku 1 tregon përqindjen e shpenzimeve të Qeverisë ndër vite për mbrojtje sociale në Kosovë. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna për përqindjen e popullsisë që mbulohet nga sistemet e mbrojtjes sociale.

Grafiku 1: Përqindja e shpenzimeve të Qeverisë për mbrojtje sociale



Të dhënat në grafikun lartë shfaqin një trend pozitiv të rritjes së shpenzimeve nga Qeveria për mbrojtje sociale, e cila tregon se është dyfishuar për periudhën 2010 deri 2019. Qëllimi i këtij treguesi është që të arrihet një mbulim i konsiderueshëm i njerëzve të varfër dhe të pambrojtur.

Të dhënat në treguesin 1.a.2 gjithashtu shfaqin një trend pozitiv të rritjes së shpenzimeve totale të Qeverisë për shërbime esenciale, si arsim, shëndetësi dhe mbrojtje/skema sociale. Shpenzimeve totale të Qeverisë për shërbime esenciale janë rritur ndër vite nga 35.4% në vitin 2010 në 47% në vitin 2017. Qëllimi i këtij indikator është që të sigurohen mjete financiare për të zbatuar programe dhe politika për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha dimensionet e saj. Përveç skemave sociale, arsimit dhe shëndetësisë kanë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, inovacionit, punësimit dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës.



**Nuk ka të dhëna për
asnjë tregues për këtë
objektiv!**

4.2. OZhQ 2 – Zero uri

Ky është objektivi 2 në Agjendën 2030, i cili gjithsej ka 8 qëllime dhe 13 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, nuk ka të dhëna në dispozicion për asnjë tregues nga gjithsej 13 tregues sa janë për këtë objektive.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të eliminohet uria dhe të sigurohet e drejta e të gjithë njerëzve, në veçanti e atyre që jetojnë në varfëri dhe gjendje të vështirë, duke përfshirë foshnjat. Gjithashtu, kjo objektive kërkon që të ketë ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm përgjatë gjithë vitit, të eliminohen të gjitha format e kequshqyerjes (sidomos të fëmijëve nën 5 vjeç), të dyfishohet prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve ushqimor të vegjël. Për më tepër, të sigurohen sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe të zbatohen praktika ripërtëritëse bujqësore që rrisin rendimentin dhe prodhimin, ndihmojnë në ruajtjen e ekosistemeve, forcojnë kapacitetin për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe që në mënyrë progresive përmirësojnë cilësinë e tokës bujqësore.

Kjo objektive është shumë e rëndësishme pasi që, vetëm atëherë kur të gjithë kanë ushqim të mjaftueshëm për të ngrënë, mund të ketë ndikime pozitive në ekonomi, shëndet, arsim, barazi dhe zhvillim shoqëror. Në të kundërtën, do të ndikohet zbatimi në shumë objektiva të Agjendës 2030, siç janë arsimi, shëndetësia dhe barazia gjinore.

Në mungesë të të dhënave shumë të rëndësishme për prevalencën e nën-ushqyerjes, pa-sigurisë ushqimore, gjatësisë trupore dhe keq-ushqyerjes ndërmjet fëmijëve nën moshën 5 vjeç dhe hapësirat e zonave bujqësore nën një bujqësi prodhuese dhe të qëndrueshme, monitorimi i këtij objektivi është i pamundur. ASK duhet të bëjë më shumë në kalkulimin e treguesve për këtë objektive, në mënyrë që të kemi një pasqyrë sesi qëndrojmë në këtë fushë dhe rrjedhimisht të mund të kanalizohen politikat në atë drejtim.



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 11 tregues në objektivin 8.

4.3. OZhQ 8 – Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike

Ky është objektivi 8 në Agjendën 2030 që ka gjithsej 12 qëllime dhe 17 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, për këtë objektive ka të dhëna në dispozicion vetëm për 6 tregues nga gjithsej 17.

Për vendet më pak të zhvilluara, qëllimet e këtij objektivi kërkojnë një rritje graduale ekonomike për kokë banori dhe rritje të paktën 7% në baza vjetore të BPV-së, rritje të produktivitetit ekonomik përmes diversifikimit, përmirësimit teknologjik dhe të inovacionit, hartimit të politikave të orientuara në zhvillim që mbështetin aktivitetet prodhuese, dhe krijimit të vendeve të punës. Gjithashtu, kjo objektive kërkon rritje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme duke kontrolluar rritjen ekonomike pa degradim të mjedisit. Në këtë drejtim të arrihet punësimi i plotë dhe produktiv për të gjithë gratë dhe burrat, duke përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar për të cilët pagesa duhet të jetë e barabartë për punën me vlerë të njëjtë. Në kuadër të kësaj, duhet të merren masa të menjëhershme dhe efektive për të hartuar një strategji për punësimin, çrrënjësor punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne, për të mbrojtur të drejtat për punë dhe për të mundësuar mjedise pune të sigurt për të gjithë punëtorët. Kjo objektive parasheh që të hartohen dhe të zbatohen politika për nxitjen e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe përkrahë kulturën dhe produktet vendore. Njëkohësisht, është i rëndësishëm hartimi dhe zbatimi i politika që forcojnë institucionet financiare vendore për të inkurajuar dhe zgjeruar qasje në shërbime bankare, qasje në sigurime dhe shërbime financiare.

Përderisa mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme për 11 treguesit e tjerë të këtij objektivi, si psh. normat vjetore të rritjes së BPV-së për personat e punësuar (produktiviteti në punë), përqindjet e punësimit joformal, përqindjet dhe numri i fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në punë të lehta, dëmtimet fatale dhe jo fatale në punë, etj. Andaj, zbatimi dhe monitorimi i saj është i mangët. Në publikimet aktuale në ASK nuk ka të dhëna rreth pjesëmarrjes së turizmit në BPV, si përqindje e BPV-së totale dhe norma vjetore e rritjes. Në BQK nuk ka statistika për përqindjen e të rriturve (15 vjeç e më të vjetër) që kanë llogari në një bankë ose institucion tjetër financiar.

Tabela 3: Treguesit e OZhQ 8 - Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
8.1.1 Norma vjetore e rritjes së BPV-së reale për kokë banor ¹³	3.3	4.4	2.8	3.4	1.2	4.1	4.1	4.2	3.8	4.13
8.5.1 Të ardhurat mesatare në orë të punonjësve ¹⁴	2.7	2.8	3	3.2	3.2	3.3	3.5	
8.5.2 Shkalla e papunësisë ¹⁵	30.9	30.0	35.3	32.9	27.5	30.5	29.6	25.7
8.5.2.a Sipas gjinisë										
Burrë	28.1	26.9	33.1	31.8	26.2	28.7	28.5	22.6
Grua	40.0	38.8	41.6	36.6	31.8	36.6	33.4	34.4
8.5.2.b Sipas grupmoshave										
Moshat (16-24)	55.3	55.9	61	57.7	52.4	52.7	55.4	49.4
8.5.2.c Sipas atyre me aftësi të kufizuara (nuk ka të dhëna)
8.6.1 Përqindja e të rinjve (të moshës 15-24 vjeç) që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim ¹⁶		...	35.1	35.3	30.2	31.4	30.1	27.4	30.1	32.7
8.10.1 (a) Numri i degëve të bankave komerciale për 100,000 banorë të rritur dhe (b) bankomate (ATM) për 100,000 banorë të rritur										

13 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. BPV 2008-2018 dhe BPV TM1 TM2 TM3 TM4

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5074/bruto-produkti-vendor-2008-2018.pdf>

14 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018. Niveli i pagave në Kosovë 2012 - 2018

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5118/niveli-i-pagave-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2012-2018.pdf>

15 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Tregut të Punës, Anketat e Fuqisë Punëtore për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/tregu-i-punes>

16 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Tregut të Punës, Anketat e Fuqisë Punëtore për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/tregu-i-punes>

Tregues i përafërt: (a) Numri i zyreve të bankave komerciale në nivel kombëtar (1.8 milion banorë) ¹⁷	223	210	207	183	165	...
Tregues i përafërt: (b) Numri i bankomateve (ATM) në nivel kombëtar (1.8 milion banorë) ¹⁸	498	540	522	512	491	...
8.b.1 Ekzistimi i një strategjie kombëtare të zhvilluar dhe të operuar për punësimin e të rinjve, si një strategji e veçantë ose si pjesë e një strategjie kombëtare të punësimit ¹⁹										

Bazuar në të dhënat në dispozicion sipas tabelës 3, në Kosovë norma vjetore e rritjes së BPV-së reale për kokë banori është rritur ndër vite nga 3.3% në vitin 2010 në 4.13% në vitin 2019. Por, siç tregojnë të dhënat kjo rritje nuk ka qenë e qëndrueshme, duke u luhatur nga 1.2% deri 4.2%. Kosova duke qenë vend në zhvillim atëherë rritja ekonomike duhet të ketë rritje stabile në mënyrë që të mund të adresojë sfida të tjera, siç është krijimi i vendeve të punës, përmirësimi i arsimit, shëndetësisë dhe rritja e standardit të jetës.

Treguesi 8.5.1 nënvizon se të ardhurat mesatare në orë të punonjësve janë rritur ndër vite nga 2.7 Euro në vitin 2012 në 3.5 Euro në vitin 2018. Kjo përfshinë pagat në sektorin publik, sektorin privat dhe ndërmarrjet publike. Vlen të theksohet se të ardhurat mesatare në orë të punonjësve që punojnë në sektorin privat janë shumë më e ulët sesa mesatarja e përgjithshme, për të cilët të ardhurat mesatare në orë të punonjësve që punojnë në sektorin privat në vitin 2018 ishin vetëm 2.3 Euro. Ky dallim në paga në mes të sektorit publik dhe privat mund të ketë shumë pasoja, si psh. mund të pengojë zhvillimin e lirshëm të sektorit

¹⁷ Banka Qendrore e Kosovës, 2019. Raporti Vjetor 2018.

E qasshme në: https://www.bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK_RV_2018.pdf

¹⁸ Banka Qendrore e Kosovës, 2019. Raporti Vjetor 2018

E qasshme në: https://www.bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK_RV_2018.pdf

¹⁹ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2020. Plani i Veprimit: Rritja e Punësimit të të Rinjve 2018-2020

E qasshme në: <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/plani-i-veprimit-rritja-e-punesimit-te-te-rinjve/?wpdmdl=969>

privat duke zvogëluar produktivitetin dhe mund të rrezikojë financat publike duke pasur shpenzimet qeveritare të larta për paga. Të kesh një punë nuk garanton një jetesë të mirë, pasi që dallimi në pagë aq i lartë zvogëlon fuqinë blerëse, ngritë çmimet dhe rritë pabarazitë ndërmjet punëtorëve.

Përkundër rritjes ekonomike ndër vite, kushtet e tregut të punës mbeten të vështira. Kosova ka një papunësi mjaft të lartë krahasuar me të gjitha vendet e rajonit. Sipas rezultateve të Anketës të Fuqisë Punëtore (AFP), shkalla e papunësisë në vitin 2019 ishte 25.7%. Papunësia më e theksuar ishte te gratë me 34.4%, krahasuar me burrat 22.6%. Kjo konfirmon prezencën e pabarazisë gjinore në Kosovë. Shkalla më e theksuar e papunësisë është tek grupmoshat 15-24 vjeçare me 49.4%. Siç mund të shihet në tabelën 3, shkalla e papunësisë në vitin 2014 ka qenë më e larta me 35.3%, ndërsa për grupmoshat 15-24 vjeçare ka qenë 61%. Sipas rezultateve të AFP-së, fuqia joaktive në vitin 2019 ishte mjaft e lartë me 59.5%, me fokus të veçantë te gratë me 78.9% krahasuar me burrat 40.3%. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna për papunësinë sipas personave me aftësi të kufizuara. Për të zbatuar këtë tregues, sipas kërkesave të Agjendës 2030, duhet të arrihet punësimi i plotë për të gjithë, gratë, burrat, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe punonjësit të kenë pagesë të barabartë për punën me vlerë të njëjtë.

Ndërsa treguesi 8.6.1 përfshin përqindjen e të rinjve (të moshës 15-24 vjeç) që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim. Në vitin 2019, kjo përqindje ishte 32.7% pra më e larta që nga viti 2014. Këta të rinj janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës dhe nuk marrin pjesë as në sistemin arsimor. Ky numër i lartë i të rinjve që nuk janë në treg të punës rrisin shqetësimet në lidhje me punësimin e të rinjve në të ardhmen, si dhe ka mundësi t'i kontribuojë rritjes së problemeve sociale.

Nuk ka të dhëna sipas metodologjisë së KB-së për treguesin 8.10.1, konkretisht (a) Numrin e degëve të bankave komerciale për 100,000 banorë të rritur dhe (b) Numrin e bankomateve (ATM) për 100,000 banorë të rritur. Por, ka të dhëna për 2 tregues tjerë të përafërt, siç janë: (a) Numri i zyrave të bankave komerciale në nivel kombëtar (1.8 milion banorë) dhe (b) Numri i bankomateve (ATM) në nivel kombëtar (1.8 milion banorë). Bazuar në të dhënat në tabelën 2, numri i zyrave të bankave komerciale (nga 223 në 165) dhe numri i bankomateve (nga 540 në 491) është zvogëluar ndër vite. Kjo nënkupton që ky tregues nuk është duke u zbatuar fare, pasi që qëllimi i këtij treguesi është që të rritet qasja në institucionet financiare dhe jo të zvogëlohet ajo. Të gjithë duhet të kenë parasysh që qasja dhe përdorimi i shërbimeve financiare është thelbësore për rritjen e bizneseve, inovacionit dhe punësimit. Një numër më i madh i bankomateve nënkupton qasje më e lartë dhe e barabartë në shërbimet financiare edhe në vende të largëta rurale.

Sa i përket treguesit 8.b.1, ekziston Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjëve në Kosovë. Ky është një plan ndërsektorial 3 vjeçar që synon rritjen e punësimit dhe përmirësimin e punësimit për të rinjtë. Ky plan është pjesë përbërëse e spektrit të dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës, të cilat si bosht orientues në nivel shtetëror e kanë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna për të matur zbatimin e këtij plani.



Nuk ka të dhëna për asnjë tregues për këtë objektiv!

4.4. OZhQ 12 – Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

Ky është objektivi 12 në Agjendën 2030, i cili gjithsej ka 11 qëllime dhe 13 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, nuk ka të dhëna në dispozicion për asnjë tregues për këtë objektivë.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

1. Zbatohet modeli i konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm,
2. Arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi eficient i burimeve natyrore,
3. Përgjysmohen mbetjet ushqimore për kokë banori në nivel global në mënyrë që të arrihet në nivelet e shitjes me pakicë dhe të zvogëlohen humbjet e ushqimit përgjatë zinxhirëve të prodhimit dhe të furnizimit, duke përfshirë dhe humbjet pas korrjeve,
4. Arrihet menaxhimi i shëndetshëm mjedisor i kimikateve dhe të zvogëlohet ndjeshëm shkarkimi i tyre në ajër, ujë dhe tokë, me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin,
5. Zvogëlohet ndjeshëm krijimi i mbeturinave përmes zbatimit të parimeve të parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit,
6. Inkurajimi i kompanive, veçanërisht ndërmarrjet e mëdha dhe transnacionale, që të adoptojnë praktika të qëndrueshme dhe të integrojnë informacionin e qëndrueshmërisë në ciklin e tyre të raportimit,
7. Përkrahen praktika të prokurimit publik që janë të qëndrueshme,
8. Sigurohet që njerëzit të marrin informacionin e duhur dhe të ndërgjegjësohen për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës në harmoni me natyrën,
9. Mbështeten vendet në zhvillim për të forcuar kapacitetet e tyre shkencore dhe teknologjike drejt modeleve më të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit,
10. Zhvillohen dhe zbatohen mjetet për të monitoruar ndikimet e zhvillimit të qëndrueshëm për turizëm të qëndrueshëm, duke krijuar vende pune dhe përkrahur kulturën dhe prodhimet vendore.

Mungesa e të dhënave për një objektivë kaq të rëndësishme e pamundëson monitorimin dhe zbatimin e tij, si psh. të dhënat për indeksin global të humbjes së ushqimit, përdorimin e brendshëm të materialeve mjedisore në raport me popullsinë, mbetjet e rrezikshme të krijuara për kokë banori dhe proporcionit të mbeturinave të rrezikshme të trajtuara, shkalla e riciklimit kombëtar dhe numri i kompanive që publikojnë raporte të qëndrueshmërisë. Gjithashtu, mungojnë të dhënat për shkallën në të cilën (i) arsimit global i qytetarëve dhe (ii) arsimit për zhvillim të qëndrueshëm (përfshirë arsimin për ndryshimet klimatike) përfshihen në (a) politikën e arsimit kombëtar; (b) kurrikula; (c) arsimimi i mësuesve; dhe (d) vlerësimi i studentëve.

Disponueshmëria e të dhënave zyrtare dhe kalkulimet e treguesve për këtë objektivë do të ofronin një pasqyrë sesi qëndron Kosova në këtë fushë. Rrjedhimisht duke u bazuar në të dhëna do të ishte më e lehtë për politikbërësit që të mund të drejtojnë politikën dhe legjislacionin në konsum dhe prodhim të qëndrueshëm në Kosovë.

OZhQ-të në fushën e çështjeve sociale

3 GOOD HEALTH
AND WELL-BEING



4 QUALITY
EDUCATION



5 GENDER
EQUALITY



10 REDUCED
INEQUALITIES



5

5. OZhQ-të në fushën e çështjeve sociale

Aspekti social është shumë i rëndësishëm në Agjendën 2030 dhe zbatimin e OZhQ-ve. Këto çështje sociale kanë të bëjnë me mirëqenien dhe përfshijnë aspekte si kujdesi shëndetësor, qasje të barabartë dhe universale në arsim cilësor në të gjitha nivelet, barazia gjinore dhe reduktimi i pabarazive brenda dhe ndërmjet shteteve.

Në Kosovë ka probleme strukturore në shumë sektorë, si psh. ai i sektorit të shëndetësisë i cili vuan nga resurse të pamjaftueshme financiare. Kushtet jo të mira në sistemin shëndetësor nuk ofrojnë kushte adekuate për trajnimin e stafit shëndetësor dhe gjithashtu kanë shtyrë që numri i profesionistëve mjek dhe infermier të lëshojnë vendet e tyre të punës. Si pasojë e mos zbatimit të reformës në sektorin e shëndetësisë, qytatarët e Kosovës ende nuk kanë sigurim shëndetësor.

Në sektorin e arsimit, ende nuk është miratuar ligji mbi arsimin e lartë i cili do të siguronte një autonomi dhe pavarësi operationale në arsim. Mungesa e mbështetjes së arsimit vërehet nga rezultatet e dobëta në testet ndërkombëtare. Kualiteti i dobët i arsimit dëmton të gjithë, e sidomos grupet e pafavorizuara. Si rezultat i kualitetit të ulët në arsim ekziston një ndërlidhje shumë e dobët në mes të tregut të punës dhe aftësimin profesional.

Sa i përket barazisë gjinore, korniza ligjore e Kosovës për barazinë gjinore është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, por fatkeqësisht për shkak të moszbatimit, gratë vazhdojnë të përjetojnë forma të ndryshme të diskriminimit gjinor në Kosovë. Gratë janë të diskriminuara në tregun e punës, duke filluar nga procesi i rekrutimit, paga, pushimet vjetore, dhe mbajtjes së pozitave udhëheqëse përbrenda organizatave. Bazuar në të dhënat në tabelën 7, dhuna ndaj grave dhe vajzave fatkeqësisht shënon një trend në rritje. Zbatimi i kornizës ligjore do të përmirësonte situatën e barazisë gjinore në Kosovë duke lejuar qasje për gratë në sferën politike, ekonomike dhe publike.

Çështjet sociale të lartpërmendura adresohen nga 4 objektiva në Agjendën 2030, të cilat janë:

Objektiva 3: Shëndet i mirë dhe mirëqënie,

Objektiva 4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe i barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënësve gjatë gjithë jetës për të gjithë,

Objektiva 5: Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat,

Objektiva 10: Reduktimi i pabarazisë brenda dhe ndërmjet shteteve.

Në vijim janë të dhënat statistikore në dispozicion për treguesit që bien mbi secilën nga këto 4 objektiva të cilat adresojnë çështjet sociale në Kosovë.

Tabela 4: Disponueshmëria e treguesve global në Kosovë në fushën e çështjeve sociale

Çështjet sociale	Numri i qëllimeve	Numri i treguesve	Tregues të disponueshëm sipas parimeve të Kombeve të Bashkuara	Tregues të përafërt	Tregues jo të disponueshëm
OZhQ 3 - SHËNDET I MIRË DHE MIRËQËNIE	13	27	3	6	18
OZhQ 4 - ARSIM CILËSOR	10	11	2	3	6
OZhQ 5 - BARAZI GJINORE	9	14	2	2	10
OZhQ 10 - ZVOGËLIM I PABARAZIVE	10	11	1	2	8
Total	42	63	8	13	42

Objektiva 3 ka gjithsej 13 qëllime dhe 27 tregues, ndërsa ka të dhëna në dispozicion vetëm për 3 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 6 tregues të përafërt, por jo sipas metodologjisë adekuate. Objektiva 4 ka gjithsej 10 qëllime dhe 11 tregues, prej të cilave ka të dhëna në dispozicion vetëm për 2 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 3 tregues të përafërt, por jo sipas metodologjisë adekuate. Objektiva 5 ka gjithsej 9 qëllime dhe 14 tregues nga të cilët ka të dhëna në dispozicion vetëm për 2 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 2 tregues të përafërt, por jo sipas metodologjisë adekuate. Objektiva 10 ka gjithsej 10 qëllime dhe 11 tregues prej të cilave ka të dhëna në dispozicion vetëm për 1 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 2 tregues të përafërt, por jo sipas metodologjisë adekuate.



Për objektivin 3 mungojnë të dhëna për 18 tregues sipas metodologjisë adekuate.

5.1 OZhQ 3 – Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Ky është objektivi 3 në Agjendën 2030, i cili ka gjithsej 13 qëllime dhe 27 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, për këtë objektiv ka të dhëna në dispozicion vetëm për 3 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 6 tregues të përafërt, por jo sipas metodologjisë adekuate.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

1. Zvogëlohet raporti global i vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 vdekje për 100,000 lindje,
2. Parandalohen vdekjet e të porsalindurve dhe e fëmijëve nën moshën 5 vjeç,
3. Eleminohen epidemitë të SIDA-s, të tuberkulozit, të malaries dhe të sëmundjeve tropikale,
4. Luftohet hepatiti dhe sëmundjet që transmetohen përmes ujit dhe sëmundjet e tjera ngjitëse,
5. Ulet për 1/3 niveli i vdekshmërisë së parakohshme nga sëmundjet jo të transmetueshme përmes parandalimit dhe trajtimit dhe nxitjes së shëndetit mendor dhe mirëqenies,
6. Përgjysmohet numri global i vdekjeve dhe lëndimeve nga aksidentet rrugore,
7. Sigurohet qasja e gjithanshme në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, përfshirë dhe planifikimin familjar, informimin dhe edukimin, dhe futjen e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare,
8. Sigurohet mbulimi shëndetësor universal,
9. Zvogëlohet dukshëm numri i vdekjeve dhe i sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe nga ndotja e ajrit, ujit dhe tokës,
10. Forcohet zbatimi i Konventës Kornizë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për kontrollin e konsumit të duhanit,
11. Mbështetet hulumtimi dhe zhvillimi i vaksinave dhe i barnave për sëmundjet e transmetueshme dhe jo të transmetueshme,
12. Rriten ndjeshëm financimet për shëndetësinë,
13. Forcohen kapacitetet e të gjitha vendeve, veçanërisht vendeve në zhvillim, për paralajmërim të hershëm dhe uljen e rrezikut dhe menaxhimin e rreziqeve shëndetësore kombëtare dhe globale.

Për këtë objektivë mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për 18 tregues, prandaj zbatimi dhe monitorimi i saj është shumë mangët. Të dhëna të rëndësishme mungojnë si p.sh. numri i infeksioneve të reja me HIV, i incidencës së tuberkulozit, malaries dhe hepatitit B. Gjithashtu, mungojnë të dhënat për shkallën e vdekshmërisë që i atribuohet sëmundjes kardiovaskulare, kancerit, diabetit ose frymëmarrjes kronike. Nuk ka statistika zyrtare rreth abuzimit të substancave, përfshirë abuzimin me narkotikët dhe përdorimin e dëmshëm të alkoolit, veçanërisht për përqindjen e abuzueseve grave në moshë riprodhuese (të moshës 15-49 vjeç) që kanë nevojë për planifikim familjar, për përqindjen e popullsisë me shpenzime të larta në ekonomitë e tyre familjare për shëndetësinë, si pjesë e shpenzimeve totale të familjes ose të ardhurave. Mungojnë të dhëna të rëndësishme mbi shkallën e vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit shtëpiak dhe ambientit, shkallës së vdekshmërisë që i atribuohet helmimit të paqëllimtë dhe prevalenca e standardizuar nga mosha e përdorimit aktual të duhanit tek personat e moshës 15 vjeç dhe më të vjetër.

Tabela 5: OZhQ 3 – Shëndet i mirë dhe mirëqenie për të gjitha moshat

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
3.1.2 Përqindja e lindjeve ku marrin pjesë personeli profesional shëndetësor ²⁰	98.3	98.4	98.9	99.6	99.7	99.6	99.7	99.8	99.9	
3.2.1 ²¹ Vdekshmëria nën 5-vjeç ²²	347	412	343	325	239	264	222	260	277	...
3.2.2 ²³ Vdekshmëria neonatale (për 100,000 lindje të gjalla) ²⁴	38	75	60	52	47	55	29	46	50	...
3.4.2 ²⁵ Shkalla e vdekshmërisë së vetëvrasjeve ²⁶	25	29	34	40	44	36	41	32	27	...
3.6.1 ²⁷ Shkalla e vdekjes për shkak të lëndimeve në trafikun rrugor për 100,000 banorë ²⁸	111	117	110	137	129	113

20 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Lindjeve për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>

21 Të dhënat janë për gjithë popullsinë (numër). Këto të dhëna nuk janë sipas standardeve ndërkombëtare për 1,000 lindje të gjalla.

22 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Vdekjeve për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>

23 Të dhënat janë për gjithë popullsinë (numër). Këto të dhëna nuk janë sipas standardeve ndërkombëtare për 1,000 lindje të gjalla.

24 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Vdekjeve për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>

25 Të dhënat janë për total popullsinë, nuk janë sipas standardeve ndërkombëtare për 100,000 banor.

26 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Vdekjeve për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>

27 Të dhënat janë për total popullsinë, nuk janë sipas standardeve ndërkombëtare për 100,000 banor.

28 Policia e Kosovës, 2019. Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës (PK).

E qasshme në: <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-vjetor-2019-shqip.pdf>

29 Nuk ka të dhëna për koeficientin e lindshmërisë por vetëm për tregues të përfaqësues, shih (i) dhe (ii).

30 Kjo nënkupton: mbulimi mesatar i shërbimeve themelore të bazuara në ndërhyrjet që përfshijnë shëndetin riprodhues, lindjes, të porsalindurve dhe të fëmijëve, sëmundjet infektive, sëmundjet jo të transmetueshme dhe aftësinë e shërbimit dhe aksesin, midis popullatës së përgjithshme dhe më të pafavorshme.

3.7.2 ²⁹ Koefficienti i lindshmërisë në adoleshencë (10-14 ose 15-19 vjeç), i shprehur për 1,000 gra të grupmoshës respektive										
(i) Numri i lindjeve të gjalla të grave në moshë më pak se 15 vjeç		1	2	1	5	0	1	1	3	
(ii) Numri i lindjeve të gjalla të grave në moshë 15 - 19 vjeç	990	937	1,096	853	921	824	702	761	697	
3.8.1 Mbulimi i shërbimeve themelore ³⁰ shëndetësore ³¹³²			100	100	100	100	100	100	100	100
3.b.1 Përqindja e popullsisë e mbuluar nga të gjitha vaksinat e përfshira në programin e tyre kombëtar ³³		97.5	98	97.5	97	95.3	94.5			
3.c.1 ³⁴ Dendësia dhe shpërndarja e punonjësve shëndetësorë ³⁵
a) Mjek	4427	4399	4669.0	4845	5560	4071	3626	3628	3486	
b) Infermier	7128	7155	8205	8047	7392	8520	8950	8989	8226	

31 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Shëndetësisë

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/shendetesia-dhe-mireqenia-sociale>

32 Kuvendi i Kosovës, 2013, Ligji për Shëndetësi.

E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666>

33 Ministria e Shëndetësisë, 2019. Plani Strategjik i Imunizimit 2019-2021.

E qasshme në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/07/Plani-i-Imunizimit-07.06.2019-liku.pdf>

34 Të dhënat janë për total popullsinë, nuk janë sipas standardeve ndërkombëtare për 10,000 banor.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018. Statistikat e Shëndetësisë.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5111/statistikat-e-shendetesise-2018.pdf>

Bazuar në të dhënat në dispozicion sipas tabelës 5, në Kosovë përqindja e lindjeve ku marrin pjesë personeli i aftë shëndetësor ishte 99.9% në vitin 2019, ku shohim një rritje të lehtë, por mjaft të rëndësishme krahasuar me vitin 2010 ku përqindja ishte 98.3. Mund të thuhet se Kosova qëndron mirë në këtë aspekt, pasi që të kesh një mjek të aftë gjatë lindjes së fëmijës është një ndërhyrje e rëndësishme shpëtuese për gratë dhe foshnjat. Mospjesëmarrja e personelit të aftë shëndetësor është e dëmshme për shëndetin e grave sepse mund të shkaktojë vdekjen e grave ose ndonjë ndërlikim tjetër.

Nga viti 2010 deri në 2018, treguesi i vdekshmërisë për fëmijët nën 5-vjeç ka pasur një rënie, por ky numër fatkeqësisht është rritur gjatë vitit 2018 krahasuar me 4 vitet e fundit. Siç mund ta shohim në tabelën 5 numri i vdekjeve të fëmijëve nën 5-vjeç në vitet 2016 dhe 2017 ka qenë më i ulët sesa në vitin 2018. Sa i përket treguesit 3.2.2 për vdekshmërinë neonatale, të dhënat tregojnë që numri ka variuar ndër vite duke mos patur një trend rritjeje apo zvogëlimi. Numri më i vogël i vdekjeve neonatale ka qenë në vitin 2010 me 38 vdekje, ndërsa më i larti në vitin 2011 me 75 vdekje neonatale. Ndërkaq, në vitin 2018 numri i vdekjeve neonatale ka qenë 50. Për të dhënat e lartpërmendura, vlen të theksohet se të dhënat janë për popullsinë në total dhe nuk janë sipas standardeve ndërkombëtare për 1,000 lindje të gjalla.

Sa i përket treguesit 3.4.2 i cili i referohet vetëvrasjeve, në Kosovë në vitin 2018 ishin 27 raste. Në mënyrë që ky numër të ulët akoma më shumë është e rëndësishme që të identifikohen sëmundjet mentale që shkaktojnë vetëvrasjet. Sa i përket vdekjeve të shkaktuara nga trafiku rrugor, numri i vdekjeve në vitin 2019 ishte 113, ndërsa në vitin 2014 ky numër ishte 111 persona. Vlen të theksohet se këto të dhënat janë për popullsinë në total dhe nuk janë sipas standardeve ndërkombëtare për 100,000 banorë.

Sa i përket treguesit 3.7.2 nuk ka të dhëna për koeficientin e lindshmërisë, por ka vetëm për indikatorë të ngjashëm. Në vitin 2018, gratë në moshë më pak se 15 vjeç kanë lindur 3 fëmijë, i cili numër është rritur në krahasim me vitet paraprake. Ndërsa gratë prej moshës 15 deri 19 vjeç kanë lindur 697 fëmijë në vitin 2018, i cili numër ka pasur një ulje nga viti në vit për këtë grupmoshë. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se lindjet e hershme mund të shoqërohen me rreziqe të shumta, si komplikime të ndryshme ose vdekje gjatë shtatëzanisë dhe procesit të lindjes. Gjithashtu, këta fëmijë janë më të rrezikuar kundrejt sëmundjeve dhe vdekjeve sesa fëmijët e lindur nga gratë më të moshuara. Prandaj, parandalimi i lindjeve të hershme në jetën e një gruaje është një masë e rëndësishme për të përmirësuar shëndetin e nënës dhe për të zvogëluar vdekshmërinë e foshnjave. Për më tepër, lindjet e hershme kanë gjasa që të ndikojnë negativisht në sferat edukative dhe profesionale të nënave.

Lindjet e hershme kanë gjasa që të interferojnë në sferën edukative dhe profesionale të nënave.”

E gjithë popullata ka akses në shërbimet themelore shëndetësore, të cilat specifikisht përfshijnë ndërhyrjet në shëndetin riprodhues, lindjes, të porsalindurve dhe sëmundjet infektive dhe ato jo të transmetueshme të fëmijëve.

Të dhëna për vaksinim ka vetëm për vitet 2011 deri 2016. Përqindja e popullsisë e mbuluar nga të gjitha vaksinat ka qenë më e larta në vitin 2012 me 98%, ndërsa më e ulëta në vitin 2016 me 94.5%. Është shqetësues fakti se mbulimi me vaksina ka pësuar rënie ndër vite dhe, për më tepër, mungojnë të dhëna për vitet e fundit duke e bërë kështu të paditur nëse ky mbulim ka pësuar rritje ose zvogëlim.

Sa i përket dendësisë dhe shpërndarjes të punonjësve shëndetësorë, nga të dhënat shohim se nga viti 2010 deri më 2018 numri i mjekëve është zvogëluar për rreth 1,000. Ndërsa, numri i infermierëve është rritur për rreth 1,000 gjatë po kësaj periudhe. Pra, në vitin 2018 kemi pasur rreth 1,000 mjek më pak sesa para 10 vjetëve. Arsyet e largimit mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga përballjet me probleme në punë (në gradime, çasje në trajnime etj.), pasiguri sociale, deri te sistemi i politizuar që nuk trajton të gjithë në mënyrë të barabartë.



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 9 tregues në objektivin 4!

5.2 OZhQ 4 – Arsim cilësor

Ky është objektivi 4 në Agjendën 2030, i cili gjithsej ka 10 qëllime dhe 11 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, ka të dhëna në dispozicion vetëm për 2 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 3 tregues të përafërt të cilët nuk janë sipas metodologjisë adekuate.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të sigurohet për të gjithë, si vajzat ashtu edhe djemtë, përfundimi i arsimimit fillor dhe të mesëm të ulët pa pagesë. Gjithashtu, ky nivel i shkollimit duhet të jetë i barabartë dhe cilësor, i cili çon në rezultate të mira të të nxënësve dhe siguron cilësi të lartë për të gjithë që në fëmijërinë e hershme. Ky objektivi kërkon që të sigurohet:

1. Përkujdesje dhe edukim parashkollor, në mënyrë që fëmijët të jenë gati për arsimim fillor,
2. Një qasje e barabartë për të gjithë në arsim teknik, profesional dhe terciar,
3. Rritje substanciale e numrit të rinjve dhe të rriturve që kanë aftësitë e nevojshme, përfshirë aftësitë teknike dhe ato profesionale,
4. Punësimi,
5. Barazia gjinore në arsim dhe të sigurohet qasje e barabartë në të gjitha nivelet e arsimimit dhe të trajnimit profesional për grupet më të ndjeshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, popujt indigjenë dhe fëmijët e pambrojtur,
6. Që të gjithë rinia dhe një pjesë e konsiderueshme e të rriturve, burra dhe gra, të arrijnë shkrim dhe lexim,
7. Që të gjithë nxënësit të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm,
8. Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve arsimore të përshtatshme për fëmijët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për ndjeshmërinë gjinore dhe të sigurohen mjedise të sigurta, jo të dhunshme dhe gjithëpërfshirëse.

Zbatimi dhe monitorimi i këtij objektivi në Kosovë është shumë i vështirë, për shkak se për këtë objektivi mungojnë të dhëna për 9 tregues sipas metodologjisë ndërkombëtare, si psh. të dhënat për:

1. Indekset e barazisë,
2. Përqindjen e fëmijëve nën moshën 5 vjeç të cilët zhvillohen në nivelin e duhur në shëndet, mësim dhe mirëqenie psikosociale,
3. Shkallën në të cilën (i) edukimi global dhe (ii) arsimit për zhvillim të qëndrueshëm, përfshirë barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, përfshihen në të gjitha nivelet në: (a) politikën kombëtare të arsimit; (b) kurrikulat; (c) arsimimi i mësuesve; dhe (d) vlerësimi i studentëve,
4. Përqindjen e shkollave me qasje në: (a) energji elektrike, (b) interneti për qëllime pedagogjike, (c) kompjuterë për qëllime pedagogjike, (d) infrastrukturë dhe materiale të adaptuara për studentët me aftësi të kufizuara, (e) ujë i pijshëm, (f) tualete të ndara për djem dhe vajza, (g) pajisje të larjes së duarve,
5. Vëllimit të ndihmave për bursa sipas sektorit dhe llojit të studimit.

Tabela 6: OZhQ 4 - Arsim cilësor¹⁴

Treguesit	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
4.1.1 Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve që arrijnë të paktën një nivel minimal të aftësisë në (i) lexim dhe (ii) matematikë, sipas gjinisë dhe nivelit të arsimit ³⁷	96.2%
4.2.2 Shkalla e pjesëmarrjes në të mësuarit e organizuar (1 vit para moshës fillestare zyrtare), sipas gjinisë ³⁸									
Dy gjinitë (numri)	24655	24945	26431	26768	25928	27508	29473	31068	32526
Djem (numri)	12946	13048	13886	13835	13366	14256	15329	16279	16978
Vajza (numri)	11709	11897	12545	12933	12562	13252	15144	14789	15548
4.3.1 Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të rriturve në arsimim dhe trajnim formal dhe joformal në 12 muajt e mëparshëm, sipas gjinisë (proxy numri) ³⁹	1962	1794	2270	1912
Djem	1249	1177	1453	1276
Vajza	713	617	817	636

37 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2011. Regjistrimi i Popullsisë 2011. Indikatorët kryesor të arsimit. E qasshme në: https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__Census%20population/?rxid=-6c75a9aa-627c-48c6-ae74-9e1b95a9c47d

38 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Arsimit sipas viteve relevante. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/arsimi>

39 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Arsimit sipas viteve relevante. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/arsimi>

4.4.1 Përqindja e të rinjve dhe të rriturve me aftësi të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), sipas llojit të aftësive									
Indikator i përafërt - qasje në internet shprehur në përqindje							88.8%	93.2%	93.2%
4.c.1 Përqindja e mësuesve në arsimim: (a) parashkollor; (b) fillor; (c) mesëm i ultë; dhe (d) mesëm të lartë që kanë marrë të paktën trajnimin minimal të organizuar të mësuesve (p.sh. trajnim pedagogjik) që kërkohet për mesimdhënie në nivelin përkatës në një shtet të caktuar ⁴⁰									100%

Sipas tabelës 4, në Kosovë përqindja e fëmijëve dhe të rinjve që arrijnë të paktën një nivel minimal të aftësisë në (i) lexim dhe (ii) matematikë në vitin 2011 ishte 96.2%. Fatkeqësisht për këtë tregues kryesor të arsimit ka të dhëna vetëm për vitin 2011, vit në të cilin është mbajtur regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë.

Për treguesin 4.2.2 nuk ka të dhëna për shkallën e pjesëmarrjes në të mësuarit e organizuar, por vetëm për numrin e fëmijëve në parashkollor nga 0-6 vjeç. Numri i të mësuarit të organizuar është rritur për më shumë se 8,000 fëmijë për një periudhë 10 vjeçare, nga 24,033 fëmijë në vitin 2010 në 32,526 fëmijë në vitin 2019. Numri i vajzave është rritur në një shkallë pak më të ulët sesa numri i djemve. Për periudhën nga viti 2010 në 2019, numri i vajzave

⁴⁰ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2017. Sistemimi i Licencimit dhe Zhvillimit të mesimdhënësve në karrierë. E qasshme në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/sistemimi-i-licencimit-dhe-zhvillimit-te-mesimdhenesve-ne-karriere.pdf>

është rritur për rreth 4,000, ndërsa numri i djemve është rritur për rreth 4,500. Pra, bazuar në këto të dhëna numri i pjesëmarrjes në mësimin e organizuar menjëherë para moshës zyrtare të hyrjes në arsimin fillor është rritur në Kosovë. Kjo i ndihmon fëmijët që të jenë më të ekspozuar ndaj aktiviteteve të organizuara të të nxëniet dhe të jenë gati për arsimin fillor.

Ngjashëm si më lartë, edhe për treguesin 4.3.1 nuk ka të dhëna për shkallën e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të rriturve në arsimim dhe trajnim formal dhe joformal, por vetëm për numrin total sipas viteve. Bazuar në të dhëna mund të shohim se numri i pjesëmarrësve në arsim apo trajnim formal dhe joformal është i ulët në përgjithësi. Në vitin 2019 ishin 1,912 të rinj prej të cilëve 1,276 ishin djem dhe 636 vajza. Pra, shihet se numri i vajzave është konsiderueshëm më i ulët. Ajo çfarë duhet ndërmarrë nga institucionet qendrore është që të ofrohen më shumë programeve jashtë-shkollore nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në mënyrë që një përqindje e madhe e njerëzve që nuk kanë mundur të kalojnë nëpërmjet një arsimimi formal të kenë mundësi të mësimin dhe aftësi dhe njohuri të reja.

Në Kosovë numri i të rinjve dhe të rriturve që kanë qasje në internet është mjaft i lartë. Vetëm në vitin 2019, 92.3% e popullsisë ishin përdorues të internetit. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna për përqindjen e të rinjve dhe të rriturve me aftësi sipas llojit siç e kërkon ky tregues, konkretisht për aftësi të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Mësuesit e të gjitha niveleve në Kosovë janë të obliguar që të vijnë trajnime pedagogjike rregullisht që organizohen nga MASHTI, për të cilin ekziston një sistemim i licencimit dhe zhvillimit të mesimdhënësve në karrierë. Kjo konsiderohet si mjaft pozitive për shkak se mendohet të kontribuojë në rritjen e profesionalizimit të mesimdhënësve, mirëpo duke parë rezultate të dobëta në këtë fushë atëherë vihet në pikëpyetje sistemi i licencimit dhe zhvillimit në karrierë.

Fusha e arsimit mbetet një fushë me plot sfida në Kosovë. Asnjë nga rekomandimet e propozuara nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për Kosovë të vitit 2018 nuk janë zbatuar. Sipas Raportit për Vëndin 2019, arsimi në Kosovë ka pasur përparim të kufizuar dhe cilësia e arsimit duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme. Për të mbështetur institucionet arsimore që të jenë në harmoni me standardet e BE-së, Kosova duhet të ketë një strategji të qartë dhe të matshme, e sidomos të zbatueshme, për zhvillim dhe drejtim të resurseve njerëzore në mënyrë që këto burime të jenë në gjendje t'iu përgjigjen nevojave të tregut të punës, si dhe trendeve globale.

41 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2017. Sistemimi i Licencimit dhe Zhvillimit të mesimdhënësve në karrierë.

E qasshme në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/sistemimi-i-licencimit-dhe-zhvillimit-te-mesimdhenesve-ne-karriere.pdf>

42 Komisioni Evropian, 2019. Raporti për Kosovën 2019.

E qasshme në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 11 tregues në objektivin 5!

5.3 OZhQ 5 – Barazi gjinore

Ky është objektivi 5 në Agjendën 2030, i cili ka gjithsej 9 qëllime dhe 14 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, ka të dhëna në dispozicion vetëm për 2 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 2 tregues të përafërt, por jo sipas metodologjisë adekuate.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

1. Parandalohen të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe vajzave të reja,
2. Eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferat publike dhe private,
3. Eliminohen të gjitha praktikrat e dëmshme, si martesat e hershme dhe të detyruar,
4. Njihet dhe vlerësohet kujdesi jo i paguar dhe puna e brendshme përmes ofrimit të shërbimeve publike, politikave të infrastrukturës dhe mbrojtjes sociale dhe promovimin e përgjegjësisë së përbashkët përbrenda shtëpisë dhe familjes, e përshtatur në kontekstin kombëtar,
5. Sigurohet pjesëmarrje dhe mundësi të barabarta për udhëheqje për gratë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike,
6. Sigurohet qasje universale në shëndetin seksual dhe riprodhues,
7. Ndërmerren reforma për t'i dhënë grave të drejta të barabarta ndaj burimeve ekonomike, si dhe qasjes në pronësi dhe kontroll mbi tokën dhe format e tjera të pasurisë, shërbimeve financiare, trashëgimisë dhe burimeve natyrore,
8. Përmirësohet përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të promovuar fuqizimin e grave,
9. Miratohet legjislacion dhe politika publike të zbatueshme për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.

Për këtë objektive mungojnë të dhëna për 11 tregues sipas metodologjisë ndërkombëtare. Kjo e bën zbatimin dhe monitorimin shumë të vështirë. Mungojnë të dhëna mbi:

1. Përqindjen e grave dhe vajzave (të moshës 15 vjeç e më shumë) që kanë përjetuar dhunë seksuale,
2. Përqindjen e kohës së shpenzuar për punë të papaguar shtëpiake dhe kujdes ndaj personave të tjerë,
3. Përqindjen e grave të moshës 15-49 vjeç që marrin vendime të mirë informuara në lidhje me marrëdhëniet seksuale, përdorimin e kontraceptivëve dhe kujdesin shëndetësor riprodhues,
4. Përqindjen e popullsisë totale bujqësore me pronësi ose të drejta të sigurta mbi tokën bujqësore,
5. Përqindja grave në pronësi të tokës dhe/ose patundshmërive,
6. Përqindjen e individëve që posedojnë një telefon celular.

Tabela 7: OZhQ 5 – Barazi gjinore

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
5.2.1 Përqindja e grave dhe vajzave (në moshë 15 vjeç e më shumë) që kanë përjetuar dhunë fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner aktual ose ish partner në 12 muajt e mëparshëm (a) forma e dhunës dhe (b) sipas grup-moshës										
Tregues i përafërt: Numri i rasteve dhunë në familje (viktimat gra) ⁴³					910	845	1,065	1,010	1,228	1,593
5.3.1 Përqindja e grave të moshës 20-24 vjeç që ishin martuar ose bashkëjetonin para moshës 18 vjeç ⁴⁴		
Tregues i përafërt: Numri i vajzave të moshës 16 - 19 vjeç që u martuan	1,434	1,901	1,698	1,485	1,547	1,431	1,299	1,273	1,337	...
Tregues i përafërt: Përqindja e vajzave të moshës 16 - 19 vjeç që u martuan	7.8	11.0	9.9	10.1	9.5	8.8	8.1	7.4	7.9	...

43 Agjencioni për Barazi Gjinore, 2019. Raporti i aktiviteteve të Policisë 2019.

E qasshme në: <https://abgj.rks-gov.net/publikimet/106/raporte-dhe-hulumtime>

44 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Kurorëzimeve në Kosovë për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>

5.5.1 Përqindja e ulëseve të mbajtura nga gratë në (a) parlament dhe (b) qeveritë lokale ⁴⁵⁴⁶										
(a) parlament	...	33.3	33.3	33.3	33	33	33	31	31	33
(b) qeverisje lokale	30	30	30	30	30	30
5.5.2 Përqindja e grave në pozita menaxheriale ⁴⁷	14.8	...	14.2	12.5	13.73	15.4	18.4	16.2

Numri i rasteve të dhunës në familje (viktimat gra) është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Ky numër ka arritur në 1,593 në vitin 2019 nga 910 sa ishin në vitin 2014. Pra, kishte një rritje prej 57% ndër këto vite. Dhuna drejtuar grave dhe vajzave është forma më e zakonshme e dhunës me bazë gjinore dhe kjo rritje përfaqëson një manifestim të pabarazisë gjinore në Kosovë. Këto të dhëna duhet të marrin vëmendjen e ligjvënësve dhe të ndërmërren programe më efektive. Nuk ka të dhëna të plota për këtë tregues, siç kërkohet nga OZhQ-të, në mënyrë që të jetë e krahasueshme me vendet tjera.

Martestat e hershme tek vajzat nga moshja 16 deri 19 vjeç është rritur viteve të fundit, ku gjatë vitit 2018 ky numër ishte 1,337 ose 7.9% e të gjitha martesave. Ndërsa në vitin 2017, ky numër ishte 1,273 ose 7.4%. Numri më i lartë i vajzave që janë martuar në këtë moshë ishte 1,901 në vitin 2011. Martesa para moshës 18 vjeç është një shkelje themelore e të drejtave të njeriut. Qeveria e Kosovës duhet të bëjë më shumë që të fuqizojë vajzat në mënyrë që ato të zgjedhin mbi ndrrimin e statusit të tyre martesor. Martesa në moshë të re ka tendencë që të shoqërohet me shumë pasoja negative, si psh. nuk lejon zhvillimin e mëtejshëm të një vajze si rezultat i shtatzënisë së hershme, izolimit social, ndërprerjes së shkollimit, kufizimit të mundësive në karrierë dhe avancimit profesional.

Siç mund të shihet në tabelën 7, përqindja e ulëseve të mbajtura nga gratë në parlament dhe qeveritë lokale nuk është as afër nivelit të përfaqësimit të barabartë gjinor. Burrat mbajnë rreth 70% të ulëseve, ndërsa gratë vetëm rreth 30%, përkundër faktit që raporti gjinor në popullsinë e Kosovës është i përafërt. Ligji për barazi gjinore duhet të zbatohet në tërësi, pasi që përfaqësimi më i lartë i grave në pozitat dhe proceset vendimarrëse lejon që shqetësimet e tyre të trajtohen në agjendat politike përmes miratimit dhe zbatimit të politikave dhe ligjeve. Përfshirja e perspektivave dhe interesave të grave, përpos që është një parakusht për barazinë gjinore, është edhe praktikë e një qeverisjeje

45 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2019. Zgjedhjet e Përgjithshme 2019.

E qasshme në: <http://www.kqz-ks.org/zgjedhjet-e-pergjithshme/>

46 Kuvendi i Kosovës, 2017. Raport për Punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Legjislaturën V.

E qasshme në: <http://www.assembly-kosova.org/shq/per-publikun/raportet-e-legjislaturave-te-kuvendit/>

47 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Tregut të Punës. Anketa e Fuqisë Punëtore për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/tregu-i-punes>

demokratike më të mirë. Gjithashtu, një parlament i përfaqësuar proporcionalisht me të dy gjinitë lejon që përvojat e ndryshme të burrave dhe grave të ndikojnë në të ardhmen sociale, politike dhe ekonomike të shoqërisë.

Kosova nuk qëndron më mirë as në përqindjen e grave në pozita menaxheriale. Sipas AFP-së në pozita ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë janë vetëm 16.2% e grave në vitin 2019 apo 2.2% më pak sesa në vitin 2018

5.4 OZhQ 10 – Zvogëlim i pabarazive

Ky është objektivi 10 në Agjendën 2030 që ka gjithsej 10 qëllime dhe 11 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, nga gjithsej 11 tregues ka të dhëna në dispozicion vetëm për 1 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 2 tregues të përafërt, por jo sipas metodologjisë adekuate.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

1. Arrihet në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme rritja e të ardhurave e 40 përqindëshit

48 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017. Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017 – 2061

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/3925/parashikimi-i-popullsis%C3%AB-2017-2061.pdf>

49 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2015. Ligji për barazi gjinore.

E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 10 tregues në objektivin 10!

të poshtëm të popullsisë,

2. Fuqizohet dhe promovohet përfshirja sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve,
3. Sigurohen mundësi të barabarta dhe të zvogëlohen pabarazitë,
4. Miratohen politika, veçanërisht politika fiskale, të pagave dhe mbrojtjes sociale, që në mënyrë progresive arrijnë një barazi më të madhe,
5. Përmirësohet rregullimi dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të rregulloreve të tilla,
6. Lehtësohet migracioni dhe lëvizshmëria e rregullt, e sigurt, dhe e përgjegjshme e njerëzve,
7. Zbatohet parimi i trajtimit të veçantë dhe diferencial për vendet në zhvillim, veçanërisht vendet më pak të zhvilluara, në përputhje me marrëveshjet e OBT-së,
8. Inkurajohet asistencë financiare për zhvillim, përfshirë investimet e huaja direkte, dhe të ulet në më pak se 3% kosto e transaksionit të remitencave të emigrantëve,
9. Eliminohen korridoret e dërgesave me kosto më të larta se 5%.

Për 10 tregues të këtij objektivi mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare, prandaj zbatimi dhe monitorimi konsiderohet që është shumë i ulët. Veçanërisht, mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme, si psh. për përqindjen e njerëzve që jetojnë nën 40% të të ardhurave mesatare, përqindja e raportimit të popullsisë që është ndjerë personalisht e diskriminuar ose ngacmuar, pjesëmarrja e tregut të punës në BPV që përfshin pagat dhe transferet e mbrojtjes sociale në sektorin privat dhe publik, të hyrat totale të resurseve për zhvillim nga donatorët dhe kostot e remitancave si pjesë e shumës së dërguar.

Tabela 8: OZhQ 10 – Zvogëlim i pabarazive

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
10.1.1 Shkalla e rritjes së shpenzimeve të familjeve ose të ardhurave për kokë banori tek 40% i poshtëm i popullsisë dhe gjithsej popullsisë ⁵⁰⁵¹										
Tregues i përafërt: (i) BPV për kokë banori	2,480	2,672	2,799	2,935	3,084	3,277	3,386	3,566	3,746	
Tregues i përafërt: (ii) Norma reale e rritjes së BPV-së	3.3	4.4	2.8	3.4	1.2	4.1	4.1	4.2	3.8	4.2
10.4.1 Pjesëmarrja e tregut të punës në BPV që përfshin pagat dhe transferet e mbrojtjes sociale ⁵²				44	51	50	54	53	54	56
10.5.1 Treguesi i Qëndrueshmërisë Financiare ⁵³										
Mjaftueshmëria e kapitalit										
(i) Kapitali rregullativ ndaj aseteve të peshuara ndaj riskut							18.7	18.1	17.4	16.8
(ii) Kapitali i klasit të parë ndaj aseteve të peshuara ndaj riskut							16.4	16.2	15.7	14.9
(iii) Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit							2.7	1.8	1.4	1.4
Cilësia e aseteve										

50 Bruto Produkti Vendor 2008-2018

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5074/bruto-produkti-vendor-2008-2018.pdf>

51 Bruto Produkti Vendor TM1, TM2, TM3, TM4 2019

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-kombetare-bpv>

52 Llogaritë Qeveritare për vitet relevante

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-qeveritare>

53 Raporti i Stabilitetit Financiar 2019 Numer 15

E qasshme në: https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK_FSR_15..pdf

(ii) Kreditë jop-erformuese ndaj totalit të kredive							5.3	3.9	2.8	2.5
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive										
(i) Korporatat tjera financiare							0.5	0.3	0.3	0.2
(ii) Korporatat publike jofinanciare							0.1	0.0	0.0	0.0
(iii) Korporatat tjera jofinanciare							64.4	63.8	63.7	63.7
(iv) Ekonomitë familjare							35.0	35.8	36.1	36.0
(v) Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare							0.02	0.01	0.01	0.01
(vi) Jo-rezidente							0.0	0.0	0.0	0.0
Profitabiliteti										
(i) Kthimi në asete							2.6	2.6	2.5	2.2
(ii) Kthimi në kapital							20.8	21.9	19.0	17.7
(iii) Margjina e interesit ndaj te hyrave bruto							74.4	64.1	79.5	81.0
(iv) Shpenzimet e jo-interesit ndaj të hyrave bruto							47.1	44.4	49.4	47.8
Likuiditeti										
(i) Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të aseteve							26.6	23.2	21.1	22.3
(ii) Asetet likuide (baza e gjerë) ndaj totalit të aseteve							31.9	27.5	24.8	26.1
(iii) Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra							34.4	30.3	28.2	30.0
(iv) Asetet likuide (baza e gjerë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra							41.3	35.9	33.2	35.1

Senzitiviteti ndaj riskut të tregut										
Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit							1.7	2.2	1.7	1.5

Siç kërkohet nga treguesi 10.1.1, në Kosovë nuk ka të dhëna për shkallën e rritjes së shpenzimeve të familjeve ose të ardhurave për kokë banori tek 40% i poshtëm i popullsisë, por ka tregues të ngjashëm për Bruto Produktin Vendor (BPV) për kokë banori dhe rritjen ekonomike ndër vite. Sipas tabelës 8, BPV vjetor për kokë banori është rritur nga 2,480 Euro në vitin 2010 në 3,746 Euro në vitin 2018. Edhe pse brenda 8 viteve ka pasur një rritje prej 66%, kjo nuk është e mjaftueshme, meqenëse në mënyrë që Kosova të konsiderohet vend i zhvilluar atëherë duhet të rritet ndjeshëm niveli i BPV-së për kokë banori, duhet të rritet eksporti dhe diversifikimi i saj, si dhe duhet të arrihet integrimi në sistemimin financiar global²¹. Rritja ekonomike ka variuar nga viti 2010 në 2019. Në vitin 2010, rritja mesatare ka qenë rreth 3.5%, ndërsa në vitin 2019 ajo ishte 4.2%. Sa i përket normës së rritjes ekonomike në vitin 2010 ajo ishte 3.3%, ndërsa më e ulëta ishte në vitin 2014 me 1.2%. Përkundër faktit të rritjes ekonomike mesatare prej 3.5%, kjo ende është e pamjaftueshme për nivelin e duhur të progresit ekonomik në vend, duke pasur parasysh që Kosova është vend në zhvillim dhe ka nevojë për një rritje të lartë stabile.

Për treguesin 10.4.1 nuk ka të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare, por ka vetëm tregues të përafërt. Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 8, shpenzimet për paga dhe kontributet sociale është rritur ndër vite, sidoqoftë këto të dhëna janë vetëm për sektorin publik. Në vitin 2014, shpenzimet përbënin 44% të buxhetit, ndërsa në vitin 2019 ky numër u rrit në 56% të buxhetit. Kjo do të thotë se në po këtë vit 44% e buxhetit u dedikuar për fushat tjera, si arsim, shëndetësi dhe investime kapitale.

Në Kosovë, të dhënat e Treguesëve të Qëndrueshmërisë Financiare (FSI) kanë filluar të publikohen që nga viti 2016 sipas standardeve ndërkombëtare. FSI ofrojnë informata mbi shëndetin financiar dhe qëndrueshmërinë e institucioneve financiare të një vendi, siç janë sektorët e korporatave dhe ekonomitë familjare.

Sa i përket mjaftueshmërisë së kapitalit, (i) kapitali rregullativ ndaj aseteve të peshuara ndaj riskut është zvogëluar nga 18.7% në vitin 2016 në 16.8% në vitin 2019. Gjithashtu, (ii) kapitali i klasit të parë ndaj aseteve të peshuara ndaj riskut është zvogëluar ndër vite, ku në vitin 2019 qëndron në 14.9%. Në vitin 2019, edhe (iii) kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit janë ulur ndjeshëm në vetëm 1.4%, ngjashëm edhe (ii) kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive janë të ulëta me vetëm 2.5% në vitin 2019 krahasuar me 5.3% në vitin 2016. Kjo pasqyron një situatë shumë të mirë për sa i përket cilësisë së portofolio të kredisë.

Në lidhje me shpërndarjen sektoriale të kredive ndaj totalit të tyre, (iii) korporatat (jofinanciare) përbëjnë pjesën kryesore të pjesëmarrësve në kredi me 63.7% vetëm gjatë vitit 2019. Sipas pasqyrës së të dhënave, kjo përqindje është e ngjashme ndër vite. Sa i përket (iv) ekonomive

⁵⁴ Kombet e Bashkuara, 2020. Perspektivat e situatës ekonomike botërore. E qasshme në: https://unctad.org/en/PublicationsLibrary/wesp2020_en.pdf

familjare, ato përbënin 36% të kredive në vitin 2019, e cila shifër ishte pak më e lartë sesa në vitin 2016 kur përbënin 35%.

Krahas dy treguesve të lartpërmendur, profitabilitetit, i cili përfshin (i) kthimin në asete ka pësuar një ulje të lehtë nga 2.6% në vitin 2016 në 2.2% në vitin 2019. Ngjashëm, (ii) kthimi në kapital poashtu ka pësuar një ulje nga 20.8% në vitin 2016 në 17.7% në vitin 2019. Ndërkaq në të kundërtën, (iii) margjina e interesit ndaj të hyrave bruto ka pasur një rritje, sidomos në vitin 2019 ku kjo margjinë ishte 81% (rreth 7% më shumë se në vitin 2016). Ndërsa, (iv) shpenzimet e jo-interesit ndaj të hyrave bruto kanë pasur një mesatare rreth 47% nga viti 2016 në 2019.

Sa i përket likuiditetit, (i) asetet likuide (bazë) ndaj totalit të aseteve në vitin 2019 ishte 22.3%. Kjo shënoi një rritje krahasuar me vitin paraprak, por një ulje krahasuar me vitin 2016 dhe 2017. Ngjashëm, (ii) asetet likuide (baza e gjerë) ndaj totalit të aseteve kishin një rritje në vitin 2019 krahasuar me vitin paraprak, por një ulje krahasuar me vitin 2017 dhe 2016. Ndërsa, (iii) asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra ishin 30% në vitin 2019 dhe (iv) asetet likuide (baza e gjerë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra ishin 35.1% në vitin 2019.

Sipas të dhënave për të gjithë treguesit e qëndrueshmërisë financiare në tabelën 8, mund të thuhet se sektori bankar i Kosovës mbetet i qëndrueshëm. Pra ka një cilësi të mirë të portofolit të kredisë, e cila tregon menaxhimin e mirë të rrezikut të kredisë së bankës dhe vërteton mjeshterin e favorshëm ekonomik për funksionimin e bankave në Kosovë.

OZhQ-të në fushën e zhvillimit të infrastrukturës dhe inovacionit

6 CLEAN WATER AND SANITATION



7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY



9 INDUSTRY, INNOVATION AND INFRASTRUCTURE



11 SUSTAINABLE CITIES AND COMMUNITIES



6

6. OZhQ-të në fushën e zhvillimit të infrastrukturës dhe inovacionit

Zhvillimi i infrastrukturës dhe inovacionit janë thelbësore për zhvillim dhe zbatim të Agjendës 2030. Infrastruktura nuk përfshin vetëm transportin, por përfshin edhe sistemet e transportit deri tek pajisjet e gjenerimit të energjisë dhe rrjetet e ujit dhe kanalizimet. Infrastruktura dhe inovacioni janë shërbime që i mundësojnë shoqërisë të funksionojë dhe ekonomisë të përparojë dhe forcohet. Në përgjithësi, zhvillimi i infrastrukturës ka ndikim pozitiv në ekonomi dhe shoqëri, i cili rrjedh si rezultat i investimeve në infrastrukturë dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës që mund të hapen përmes inovacionit, ndërtimit apo mirëmbajtjes së projekteve infrastrukturore. Për më tepër, përfitimet e shoqërisë përmes zhvillimit të infrastrukturës përfshijnë ofrimin e transportit publik që u bën më të lehtë banorëve të zonave rurale të marrin pjesë në fuqinë punëtore. Ndërsa, duke investuar në sisteme të furnizimit me ujë të pastër dhe sisteme të kanalizimeve zvogëlohet vdekshmëria e nënave. Infrastruktura gjithashtu përmirëson barazinë gjinore duke ju dhënë qasje në fuqi punëtore të dy gjinive. Gjithashtu, një sistem energjetik dhe i pastër mbështet të gjithë sektorët tjerë si bizneset, mjekësinë, arsimin e deri te bujqësia, infrastruktura, teknologjinë moderne.

Në lidhje me sektorin e ujërave, Kosova ka një Strategji Kombëtare të Ujit 2017-2036, duke përfshirë edhe planin e veprimit. Sfida kryesore për këtë strategji mbetet implementimi dhe monitorimi i saj dhe publikimi i statistikave rreth zbatimit të saj. Duke marrë parasysh prioritetet e Kosovës në procesin e integritimit evropian, strategjia duhet të harmonizohet mëtej me legjislacionin e ujërave të BE-së.

Zbatimi i treguesve të OZhQ-ve në fushën e energjisë ka një trend të ngadalshëm drejt kalimit në një sistem të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm të energjisë, duke investuar në burime të ripërtritshme të energjisë dhe duke adoptuar teknologjitë dhe infrastrukturën e energjisë së pastër. Ashtu siç kërkon edhe Agjenda 2030, për të mos mbetur prapa, investimet në infrastrukturë, zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe inovacion janë shumë të rëndësishme.

Zhvillimi i infrastrukturës dhe inovacionit adresohet nga 4 objektiva në Agjendën 2030, siç janë:
Objektiva 6: Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë,

Objektiva 7: Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë,

Objektiva 9: Ndërtimi i infrastrukturës rezistente, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit,

Objektiva 11: Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurt, rezistente dhe të qëndrueshme.

Në vijim janë të dhënat statistikore në dispozicion për treguesit që bien mbi secilën nga këto 4 objektiva të cilat adresojnë zhvillimin e infrastrukturës dhe inovacionit në Kosovë.

Tabela 9: Disponueshmëria e treguesve global në Kosovë në fushën e infrastrukturës dhe inovacionit

Çështjet e infrastrukturës dhe inovacionit	Numri i qëllimeve	Numri i treguesve	Tregues të disponueshëm sipas parimeve të Kombeve të Bashkuara	Tregues të përafërt	Tregues jo të disponueshëm
OZhQ 6 - UJË I PASTËR DHE KANALIZIME	8	11	2	0	9
OZhQ 7 - ENERGI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËRT	5	6	1	2	3
OZhQ 9 - INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË	8	12	3	0	9
OZhQ 11 - QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME	10	11	0	4	7
Total	31	40	6	6	28

Objektiva 6 ka gjithsej 8 qëllime dhe 11 tregues dhe ka të dhëna në dispozicion vetëm për 2 tregues sipas metodologjisë adekuate. Objektiva 7 ka gjithsej 5 qëllime dhe 6 tregues, prej të cilave ka të dhëna në dispozicion për vetëm 1 tregues, ndërsa për 2 tregues të dhënat janë nga Banka Botërore. Objektiva 9 ka gjithsej 8 qëllime dhe 12 tregues dhe ka të dhëna në dispozicion për vetëm 3 tregues sipas metodologjisë adekuate. Objektiva 11 ka gjithsej 10 qëllime dhe 11 tregues, nuk ka të dhëna të plota për asnjë tregues, ndërsa ka të dhëna për 4 tregues pjesërisht në harmoni me metodologjinë adekuate.



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 9 tregues në objektivin 6!

6.1 OZhQ 6 – Ujë i pastër dhe kanalizime

Ky është objektivi 6 në Agjendën 2030 që ka gjithsej 8 qëllime dhe 11 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, për këtë objektive ka të dhëna në dispozicion vetëm për 2 tregues sipas metodologjisë adekuate nga gjithsej 11 treguesit e saj.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

1. Arrihet furnizimi i plotë dhe i barabartë me ujë të pijshëm,
2. Mundësohet qasje në sistemin e kanalizimeve dhe të higjienës të përshtatshme dhe të barabartë për të gjithë,
3. Përmirësohet cilësia e ujit duke zvogëluar ndotjen, eliminuar hedhjen e mbetjeve jashtë vendit të përcaktuar dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza të patrajtuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin,
4. Rritet ndjeshëm përdorimi efikas i ujit në të gjithë sektorët dhe të sigurohet tërheqja e qëndrueshme e tij dhe furnizimi me ujë të pijshëm për të adresuar mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit,
5. Zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore,
6. Mbrohen dhe të rigjenerohen ekosistemet ujore, përfshirë dhe malet, pyjet, luginat, lumenjtë, ujërat nëntokësore dhe liqenet,
7. Zgjerohet bashkëpunimi ndërkombëtar, dhe të mbështetet,
8. Forcohet pjesëmarrja e komunitetit lokal në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe të kanalizimeve.

Në Kosovë mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për 9 tregues për këtë objektive, prandaj zbatimi dhe monitorimi konsiderohet që është shumë i vështirë. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme për përqindjen e popullsisë që përdorë shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt, duke përfshirë larjen e duarve me sapun dhe ujë dhe numri i vendeve të furnizuar me ujë të cilësisë së mirë. Gjithashtu, mungojnë të dhëna rreth ndryshimit të efikasitetit të përdorimit të ujit me kalimin e kohës, si dhe nuk ka të dhëna për nivelin e stresit të ujit (water stress test). Nuk ka të dhëna për shkallën e zbatimit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, ndryshimi në masën e ekosistemeve të lidhura me ujin me kalimin e kohës, dhe për përqindjen e njësive administrative vendore që kanë politika dhe procedura të përcaktuara dhe operative për pjesëmarrjen e komuniteteve lokale në menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve.

Tabela 10: OZhQ 6 – Ujë i pastër dhe kanalizime

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
6.1.1 Përqindja e popullsisë që përdor shërbime të ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurtë ⁵⁵	...	63.96	71.65	74.86	78.94	87.52	89.59	87.17	86.31	...
6.3.1 Përqindja e ujërave të ndotura të trajtuara në mënyrë të sigurtë ⁵⁶	1.9	0.9	1.4	1.2	1.6	1.7	...

Sipas të dhënave në dispozicion, përqindja e popullsisë që përdor shërbime të ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurtë është rritur dukshëm nga 63.96% sa ishte në vitin 2011 në 86.31% në vitin 2018, por siç mund të shihet në tabelën 10 kjo përqindje është ulur në vitin 2018 nëse krahasohet me 3 vitet paraprake. Shërbimet e ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurtë ishte në nivelin më të lartë në vitin 2016 me 89.59%. Kjo tregon se në Kosovë kemi rreth 15% të popullsisë që nuk ka qasje në ujë të pastërt.

Përqindja e ujërave të ndotura të trajtuara në mënyrë të sigurtë është shumë e ulët në Kosovë. Sipas të dhënave zyrtare vetëm 1.7% e ujërave të ndotura trajtohen, kurse në të gjitha vendet e zhvilluara trajtimi bëhet për më shumë se 90% të ujërave të ndotura.

⁵⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Ujërave në Kosovë
E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5366/statistiakt-e-ujit-20182019.pdf>

⁵⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Ujërave në Kosovë.
E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5366/statistiakt-e-ujit-20182019.pdf>



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 5 tregues në objektivin 7.

6.2 OZhQ 7 – Energji e përbalueshme dhe e pastërt

Ky është objektivi 7 në Agjendën 2030, që ka gjithsej 5 qëllime dhe 6 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, ka të dhëna në dispozicion për vetëm 1 tregues, ndërsa për 2 tregues të tjerë të dhënat janë nga Banka Botërore.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

1. Sigurohet qasje e përgjithshme në shërbime të përbalueshme dhe moderne të energjisë,
2. Rritet ndjeshëm pjesa që zë energjia e rinovueshme në totalin e energjisë të dyfishohet norma globale e përmirësimit të eficiencës së energjisë,
3. Forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar për të lehtësuar hyrjen në teknologjinë e energjisë së pastër, përfshirë energjinë e ripërtitshme dhe eficiencën e energjisë dhe teknologjinë e avancuar dhe më të pastër të karburanteve fosile,
4. Promovoni investimet në infrastrukturën energjetike dhe teknologjinë e energjisë së pastër, si dhe të zgjerohet infrastruktura dhe teknologjia për furnizimin e shërbimeve moderne dhe të qëndrueshme të energjisë.

Në Kosovë, mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për 5 tregues për këtë objektivi, prandaj zbatimi dhe monitorimi konsiderohet që është shumë i vështirë. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme për përqindjen e popullsisë me qasje në energji elektrike dhe përqindja e popullsisë me mbështetje parësore ndaj lëndëve djegëse të pastërta ku të dhënat për këta 2 tregues në tabelën 8 janë nga Banka Botërore. Mungojnë të dhënat për proporcionin e energjisë së ripërtitshme në totalin e konsumit përfundimtar të energjisë, për investimet në efikasitetin e energjisë si një pjesë e BPV-së dhe sasisë së investimeve të huaja direkte në transferimin financiar për infrastrukturën dhe teknologjinë në shërbime të zhvillimit të qëndrueshëm. Për më tepër, mungojnë të dhënat e të hyrave financiare ndërkombëtare në mbështetje të hulumtimit dhe zhvillimit të energjisë së pastër dhe prodhimit të energjisë së ripërtitshme, përfshirë në sistemet hibride.

Tabela 11: OZhQ 7 – Energji e përbalueshme dhe e pastërt

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
7.1.1 Përqindja e popullsisë me qasje në energji elektrike ⁵⁷	99	100	100	100	100	100	100	100	100	100
7.1.2 Përqindja e popullsisë që kryesisht përdorë lëndë djegëse të pastërta ⁵⁸	97	98.2	98.4	97.8	97.2	97.7
7.3.1 Intensiteti i energjisë primare i matur në terma të BPV-së ⁵⁹	...	0.175	0.151	0.142	0.141	0.131	0.139

Bazuar në të dhënat e tabelës 11, të gjithë qytatarët në Kosovë kanë qasje në energji elektrike. Ndërsa përqindja e popullsisë me mbështetje parësore ndaj lëndëve djegëse, të cilat përfshijnë naftën, gazin dhe qymyrin për prodhim të energjisë elektrike, në vitin 2015 ishte 97.7%.

Intensiteti i energjisë primare në vitin 2016 ishte 0.139. Intensiteti i energjisë është një tregues sesa energji përdoret për të prodhuar një njësi të outputit ekonomik. Pra, është një tregues i efikasitetit me të cilin ekonomia është në gjendje të përdorë energji për të prodhuar output ekonomik. Një raport më i ulët tregon se më pak energji përdoret për të prodhuar një njësi të prodhimit.

Kosova vazhdon të mbështetet pothuajse ekskluzivisht në linjit si burim kryesor i energjisë dhe në dy termocentrale të vjetëruara, ku këto termocentrale që prodhojnë energji nga qymyri kontribuojnë në nivel të lartë të ndotjes. Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesat e OZhQ-ve për zvogëlim të ndotjeve.

⁵⁷ Banka Botërore, 2018. Qasja në Energji Elektrike 2010 – 2018.

E qasshme në: <https://data.worldbank.org/indicator/EG.ELC.ACCS.ZS?locations=XK&view=chart>

⁵⁸ Banka Botërore, 2018. Prodhimi i Energjisë Elektrike 2010 – 2015.

E qasshme në: <https://data.worldbank.org/indicator/EG.ELC.FOSL.ZS?locations=XK&view=chart>

⁵⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Eficienca e Energjisë në Kosovë 2011-2016

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/3924/efi%C3%A7ienca-e-energjis%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2011-2016.pdf>



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 9 tregues në objektivin 9.

6.3 OZhQ 9 – Industri, inovacion dhe infrastrukturë

Ky është objektivi 9 në Agjendën 2030, i cili ka gjithsej 8 qëllime dhe 12 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, për objektivin 9 ka të dhëna në dispozicion për vetëm 3 tregues sipas metodologjisë adekuate nga gjithsej 12 treguesit për këtë objektivë.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

Zhvillohet një infrastrukturë cilësore, e sigurt, e qëndrueshme dhe rezistente për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e njerëzve,

Promovohet industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm,

Rritet qasja e ndërmarrjeve të vogla industriale dhe e ndërmarrjeve të tjera në shërbimet financiare, kredi të përballueshme,

Azhurnonet infrastruktura e industrive për t'i bërë ato të qëndrueshme dhe të ketë adoptim më të madh të teknologjive dhe proceseve të pastra,

Rriten hulumtimet shkencore, aftësitë teknologjike të sektorëve industrialë dhe të inkurajohet inovacioni,

Mbështetet zhvillimi teknologjik vendor, hulumtimet dhe inovacioni, duke përfshirë sigurimin e një mjedisi politik të favorshëm diversifikimin industrial dhe shtimin e vlerës së mallrave,

Rritet në mënyrë të konsiderueshme qasja në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Në Kosovë, mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për 9 tregues për këtë objektiv, prandaj zbatimi dhe monitorimi konsiderohet që është shumë i vështirë. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme për përqindjen e popullësisë rurale që jeton brenda 2 km pa qasje në rrugë gjatë një sezoni, vlera e shtuar e prodhimit si proporcion i BPV-së dhe për kokë banori. Mungojnë të dhëna për përqindjen e industrive të vogla mbi vlerën e shtuar të industrisë totale, përqindja e industrive të vogla që kanë kredi ose linjë krediti, emetimi i CO₂ për njësi të vlerës së shtuar, shpenzimet për hulumtime dhe zhvillim si pjesë e BPV-së dhe numri i hulumtuesve (ekuivalent me orar të plotë) për 1 milion banorë. Kosova ka pranuar dhe ende pranon mbështetje ndërkombëtare për zhvillim dhe infrastrukturë, por nuk ka të dhëna për shumën e saktë ndër vite.

Tabela 12: OZhQ 9 – Industri, inovacion dhe infrastrukturë

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
9.1.2 Volumi i mallrave dhe pasagjerëve, sipas mënyrës së transportit (numër 1,000) ⁶⁰										
(i) Udhëtarët sipas metodës së transportit (numër 1,000)										
Transporti ajror		1422	1527	1629	1405	1549	1744	1885	2162	2370
Transporti hekurudhor		357	366	369	339	269	279	156	120	121
(ii) Sasia e mallrave të transportuara në mijë ton (numër ton 1,000)										
Transporti hekurudhor		1,001	826	904	848	736	249	430	479	550
9.2.2 Punësimi në industrinë prodhuese si përqindje e punësimit total ⁶¹			14.3		13.8	14.6	13.2	13.2	10.3	11.9
9.c.1 Përqindja e popullsisë e mbuluar nga rrjeti mobil, sipas teknologjisë ⁶² (GSM)	99	99	99	99	99	100	100	100	100	

Bazuar në të dhënat në tabelën 12, në vitin 2019 nëpërmjet transportit ajror kanë udhëtuar rreth 2.4 milion udhëtarë, ndërsa në vitin 2011 ishin rreth 1.4 milion udhëtarë. Pra shihet një rritje e konsiderueshme e udhëtarëve që kanë përdorur transportin ajror, e cila indirekt tregon për një rritje të standardit dhe fluksit që kontriboun në ekonomi. Në anën tjetër, në vitin 2019 rreth 120 mijë udhëtarë kanë udhëtuar me transport hekurudhor. Mirëpo, numri i udhëtarëve me transport hekurudhor është zvogëluar ndër vite. Vetëm në vitin 2011, transporti hekurudhor u përdorë nga më shumë se 350 mijë udhëtarë.

Sa i përket sasisë së mallrave të transportuara përmes transportit hekurudhor, në vitin 2019 u transportuan mallra në peshë prej 550 mijë ton. Kjo paraqet një rritje krahasuar me vitet 2018, 2017 dhe 2016, por në të kundërtën paraqet vetëm gjysmën e mallrave të transportuara në vitin 2011. Në lidhje me transportin e mallrave nëpërmjet vijave ajrore ka mungesë të madhe të të dhënave.

Punësimi në industrinë prodhuese si përqindje e punësimit total është mjaft i ulët në Kosovë. Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, në vitin 2019 në industrinë

60 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Transportit.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5282/transporti-tm4-2019-shqip.pdf>

61 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Anketa e Fuqisë Punëtore për vitet relevante.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/tregu-i-punes>

62 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, 2017. Raporti Vjetor për vitet 2010 deri 2018.

E qasshme në: <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,32>

prodhuese ishin të punësuar vetëm 11.9% ndaj punësimit total, ndërsa në vitin 2018 punësimi në industrinë e prodhimit ishte edhe më i ulët me 10.3%. Punësimi më i lartë në këtë industri u arrit në vitin 2015.

Përqindja e popullsisë e mbuluar nga rrjeti mobil mund të konsiderohet si një tregues minimal për qasjen në TIK, pasi që u siguron njerëzve mundësinë të abonohen dhe të përdorin shërbime telefonike për të komunikuar. Gjatë dekadës së fundit, rrjetet celulare janë zgjeruar me shpejtësi dhe kanë ndihmuar në tejkalimin e pengesave themelore të infrastrukturës që ekzistonte kur kishim vetëm rrjetet e telefonisë fikse (shpesh të kufizuara në zona urbane). Përqindja e popullsisë e mbuluar nga rrjeti mobil (GSM), ka qenë i mbuluar plotësisht, me 100%, për të gjithë popullsinë që nga viti 2015, edhe pse niveli i parashikuar për vitet 2010-2024 për këtë mbulueshmëri ishte 99%.

Industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm, së bashku me inovacionin dhe infrastrukturën, janë forcat ekonomike dinamike që rrisin punësimin dhe të ardhurat. Këto të trija luajnë një rol kryesor në prezantimin dhe promovimin e teknologjive të reja, duke lehtësuar tregtinë ndërkombëtare dhe duke mundësuar përdorimin efikas të burimeve. Kosova duhet të vendos standarde dhe të ketë rregullore që sigurojnë që projektet dhe iniciativat e ndërmarrjeve të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme.



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 11 tregues në objektivin 11.

6.4 OZhQ 11 – Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

Ky është objektivi 11 në Agjendën 2030, i cili ka gjithsej 10 qëllime dhe 11 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, nuk ka të dhëna të plota për asnjë tregues, ndërsa ka të dhëna për 4 tregues pjesërisht në harmoni me metodologjinë adekuate nga gjithsej 11 treguesit për këtë objektivi. Të dhënat për treguesit e këtij objektivi janë në dispozicion vetëm për vitet 2015 – 2018.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

Sigurohet për të gjithë njerëzit qasje për strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm dhe shërbime themelore publike,

Sigurohet për të gjithë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik,

Zgjerohet urbanizimi në nivel gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të forcohen kapacitetet për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve të qëndrueshme,

Forcohen përpjekjet për të mbrojtur dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore,

Zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i njerëzve të prekur nga fatkeqësitë dhe të ulen ndjeshëm humbjet ekonomike të drejtpërdrejta në BPV,

Zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për kokë banori në qytete, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve komunale dhe mbetjeve të tjera.

Kjo objektivë ka gjithashtu për qëllim që të sigurohet qasje e gjithanshme në hapësirat publike të gjelbra, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, si dhe të mbështeten lidhjet pozitive ekonomike, sociale dhe mjedisore ndërmjet zonave urbane, ndër-urbane dhe rurale, kështu duke forcuar planifikimin për zhvillim në nivel kombëtar dhe rajonal. Gjithashtu, kjo objektivë ka për qëllim që të rritet ndjeshëm numri i qyteteve dhe vendbanimeve që zbatojnë politika dhe plane të integruara gjithëpërfshirëse dhe mbështesin efikasitetin e resurseve.

Në Kosovë, mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për të gjithë 11 treguesit për këtë objektivë, prandaj zbatimi dhe monitorimi konsiderohet që nuk është i mundur. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme për përqindjen e popullsisë urbane që jeton në lagjet e varfra, vendbanimet jo formale ose strehime jo të përshtatshme, për përqindjen e popullsisë që ka qasje të përshtatshme në transportin publik sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara dhe raporti i punimit të tokave me ritmin e rritjes së popullsisë. Nuk ka të dhëna për shpenzimet totale (publike dhe private) për kokë banori të shpenzuara për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, për pjesën mesatare të zonës së ndërtuar të qyteteve që është hapësirë e hapur për përdorim publik. Mungojnë të dhënat për përqindjen e viktimave të ngacmimit fizik ose seksual dhe për përqindjen e mbështetjes financiare që është e ndarë në ndërtimin e ndërtesave të qëndrueshme, elastike dhe me resurse efikase.

Tabela 13: OZhQ 11 – Qytete dhe komunitete të qëndrueshme ⁴

Treguesit	2015	2016	2017	2018	2019
11.3.2 Përqindja e qyteteve me një strukturë pjesëmarrjeje të drejtpërdrejtë të shoqërisë civile në planifikimin dhe menaxhimin urban që funksionojnë rregullisht dhe në mënyrë demokratike ⁶³
11.6.1 Raporti i mbetjeve të ngurta urbane të mbledhura rregullisht dhe të depozituara sipas normave ndaj sasisë gjithsej mbetjeve të ngurta urbane të gjeneruara, sipas qyteteve ⁶⁴
(i) Sasia e mbeturinave të ricikluara (ton)			1,242	3,193	
11.6.2 Nivelet mesatare vjetore të grimcave të imëta (p.sh. PM2.5 dhe PM10) në qytete (matur per popullsinë) ⁶⁵
Nivelet mesatare vjetore të grimcave (PM10) (i) Prishtina me rrethinë (IHMK, Rilindje, Palaj, Obiliq, Dardhishtë)	51	41	40	36.1	
11.a.1 Përqindja e popullsisë që jeton në qytete që zbatojnë planet e zhvillimit urban dhe rajonal që integrojnë parashikimet e popullsisë dhe nevojat e resurseve sipas madhësisë së qytetit
11.b.1 Numri i vendeve që adoptojnë dhe zbatojnë strategji kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat në përputhje me Kornizën Sendai për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive 2015-2030 ⁶⁶

Nuk ka të dhëna statistikore për treguesin 11.3.2, por ka të dhëna sasiore në Kosovë për planet dhe strategjitë e të gjitha qyteteve që bazohen në qasjen pjesëmarrëse dhe konsultuese nga të gjitha palët e interesit, përfshirë OShC-të. Pas hyrjes në fuqi të Rregullores së Qeverisë Nr. 05/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik më 1 janar 2017, Qeveria e Kosovës ka lansuar platformën online për konsultime publike, e cila shërben si mjet kryesor për zbatimin e standardeve të aprovuara minimale në procesin e politikbërjes. Kjo platformë vlen edhe për treguesin 11.a.1 për të cilin mungojnë të dhënat.

Për treguesin 11.6.1, të dhënat nuk janë të ndara sipas qyteteve apo me përqindje, por ka të dhëna vetëm për sasinë e mbeturinave të ricikluara. Në vitin 2018, në Kosovë u ricikluan 3,193 ton mbeturina, ku shohim më shumë se dyfishim të riciklimit krahasuar me vitin 2017.

⁶³ Qeveria e Republikës së Kosovës, 2020. Platforma e Konsultimeve Publike.

E qasshme në: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

⁶⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018. Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2018.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5138/anketa-e-mbeturinave-t%C3%AB-trajtuara-amt-2018.pdf>

⁶⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018. Disa fakte mbi mjedisin 2018.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/4650/disa-fakte-mbi-mjedisin-2018.pdf>

⁶⁶ Ministria e Punëve të Brendshme, 2016. Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimtimit 2016 – 2020.

E qasshme në: https://mpb.rks-gov.net/Documents/SZRrF%20%20shqip_1.pdf

Ngjashëm edhe për treguesin 11.6.2, nuk ka të dhëna të plota, ndërsa ka të dhëna vetëm për nivelet mesatare vjetore të grimcave (PM10) për Prishtinën me rrethinë (IHMK, Rilindje, Palaj, Obiliq dhe Dardhishtë). Sipas këtyre të dhënave, niveli PM10 është zvogëluar ndër vite nga 51 sa ishte në vitin 2015 në 36.1 në vitin 2018. Për të pasur një pasqyrë më të qartë për Kosovën, më shumë të dhëna duhet të jenë në dispozicion pasi që këto grimca janë në gjendje të depërtojnë thellë në traktin respirator dhe për këtë arsye përbëjnë një rrezik për shëndetin publik duke rritur vdekshmërinë nga infeksionet e frymëmarrjes dhe sëmundjet e tjera, si ato kardiovaskulare, kanceri i mushkërive, etj

OZhQ-të në fushën e mjedisit

13 CLIMATE ACTION



14 LIFE BELOW WATER



15 LIFE ON LAND



7

7. OZhQ-të në fushën e mjedisit

Qëndrueshmëria mjedisore është thelbësore për zhvillimin dhe zbatimin e Agjendës 2030. Kjo nuk përfshin që të ndërmerren veprime vetëm për klimën, por edhe për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve oqeanike dhe detare, si dhe për mbrojtjen, rehabilitimin dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore. Fatkeqësisht, në të gjithë botën nivelet e gazrave vazhdojnë të rriten, duke bërë kështu që ndryshimi klimatik të ndodh me ritme shumë më të larta sesa janë parashikuar. Këto efekte nuk njohin kufi, andaj janë të dukshme edhe në Kosovë. Pyjet mbulojnë rreth 1/3 e sipërfaqes së planetit tonë dhe janë esenciale për jetën në Tokë për shkak se ato kontribuojnë në ajrin që marrim, ujin që pimë e deri tek ushqimi që hamë, prandaj janë shumë të rëndësishme të trajtohen në mënyrë të qëndrueshme.

Shumë vende, sidomos vendet e zhvilluara, janë duke prioritizuar mjedisin dhe janë duke zbatuar masa konkrete për mbrojtjen e tij, duke pasur parasysh rrezikun dhe pasojat mjedisore të shkaktuara në Tokë. Fatkeqësisht, në Kosovë kjo fushë ende nuk është duke u prioritizuar në agjendat politike dhe nuk merr vëmendje në atë masë sa duhet.

Në teori, në Kosovë ekziston një kornizë ligjore që është pothuajse e konsoliduar që rregullon mbrojtjen e mjedisit. Kosova zotëron Strategjinë e Kosovës për Mjedisin SMM (2013–2022) dhe Strategjinë për Ndryshimet Klimatike 2014-2024, plotësuar dhe ndryshuar me Strategjinë për Ndryshimet Klimatike 2019-2028 dhe Planin e Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019-2021. Objektivat e Strategjisë së Kosovës për Mjedisin janë që Kosova të zhvillojë kapacitete për t'i përmbushur obligimet e saja të ardhshme sipas Konventës UNFCCC, si dhe që Kosova të ngadalësojë rritjen e emetimeve të gazrave serrë përmes rritjes së efijencës së energjisë në të gjithë sektorët, zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në Kosovë ekziston një kornizë ligjore dhe strategjike që rregullon mbrojtjen e mjedisit, por nuk i'u është kushtuar vëmendje e mjaftueshme integritetit të treguesëve të OZhQ-ve në këto dokumente. Të dhënat përkatëse që kanë të bëjnë me mjedisin mungojnë. Për shkak të mungesës së statistikave të sakta është e pamundur që të merren vendime të duhura dhe të zgjidhen me efikasitet sfidat mjedisore, siç kërkohen nga OZhQ-të.

Prioritetet specifike të Strategjisë për Ndryshimet Klimatike janë:

1. Zhvillimi i kapaciteteve të Kosovës për përmbushjen e obligimeve në kuadër të Konventës së UNFCCC dhe BE-së,
2. Zvogëlimi i emetimeve të gazrave serrë, zhvillimi i mekanizmave të rinjë dhe përmirësimi i atyre aktual në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në sektorët me rëndësi ekonomike që janë të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike,
3. Ngritja e kapaciteteve të përshtatjes së ekosistemeve natyrore dhe ngritja e kapaciteteve të partnerëve, akterëve qendror dhe lokal për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes në proceset e zhvillimit. Këta objektive targetojnë disa nga treguesit e OZhQ-ve, por fatkeqësisht nuk ka ndonjë të dhënë apo raport që tregon deri në çfarë mase janë zbatuar objektivet dhe nuk ka të dhëna statistikore relevante.

Në Kosovë, adresimi i çështjeve mjedisore dhe ndryshimeve klimatike janë gjithashtu kërkesa të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA)⁶⁷. Në nenin 115 të MSA-së kërkohet që të forcohet bashkëpunimi në fushën e mjedisit për të ndaluar degradimin e mëtejshëm mjedisor dhe të fillojë përmirësimi i gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Ndërsa, në nenin 116 kërkohet që të forcohet bashkëpunimi dhe të zhvillohet politika klimatike dhe të përfshihen problematikat klimatike në energji, transport, industri, bujqësi, arsim dhe në politikat tjera përkatëse.

Ka mungesë të kriterëve dhe treguesve për monitorim adekuat në fushën e mjedisit. Sistemi i monitorimit të mjedisit nuk është ende në një nivel të kënaqshëm. Organet kompetente nuk raportojnë rregullisht në baza vjetore, për më tepër mungesa e këtij raportimi nuk ofron dëshmi në adresimin e sfidave në këtë sektor. Prandaj, është shumë e rëndësishme që përmbushjet e detyrimeve mjedisore të raportohen në Kuvend.

Çështjet e mjedisit adresohen nga 3 objektive në Agjendën 2030, por vetëm 2 janë relevante për Kosovën, siç janë:

Objektiva 13: Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre,

Objektiva 14: Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm (nuk është relevante për Kosovën),

Objektiva 15: Mbrojtja, rehabilitimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirëzimit, ndalimi e kthimi mbrapa i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Në vijim janë të dhënat statistikore në dispozicion për treguesit që bien mbi secilën nga këto 2 objektiva të cilat adresojnë çështjet e mjedisit në Kosovë.

Tabela 14: Disponueshmëria e treguesve global në Kosovë në fushën e mjedisit

Çështjet e mjedisit	Numri i qëllimeve	Numri i treguesve	Tregues të disponueshëm sipas parimeve të Kombeve të Bashkuara	Tregues të përafërt	Tregues jo të disponueshëm
OZhQ 13 – VEPRIM PËR KLIMËN	5	8	0	2	6
OZhQ 15 – JETA NË TOKË	12	14	0	2	12
Total	17	22	0	4	18

Objektiva 13 ka gjithsej 5 qëllime dhe 8 tregues, mirëpo nuk ka të dhëna për asnjë tregues, ndërsa ka dokumente strategjike për 2 tregues nga gjithsej 8 treguesit për këtë objektive. Objektiva 15 ka gjithsej 12 qëllime dhe 14 tregues prej të cilave nuk ka të dhëna të plota për asnjë tregues, ndërsa ka dokumente strategjike për 1 tregues dhe të dhëna për vetëm 1 vit për 1 tregues tjetër nga gjithsej 14 treguesit për këtë objektive.

⁶⁷ Ministria e Integrimit Evropian, 2016. Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. E qasshme në: https://www.mei-ks.net/repository/docs/msa_shq.pdf



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuatë për 8 treguesit e objektivit 13.

7.1 OZhQ 13 – Veprim për klimën

Ky është objektivi 13 në Agjendën 2030, i cili ka gjithsej 5 qëllime dhe 8 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, nuk ka të dhëna për asnjë tregues, ndërsa ka dokumente strategjike për 2 tregues nga gjithsej 8 tregues sa ka kjo objektivi.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

Forcohen aftësitë ndaj rreziqeve që lidhen me klimën dhe fatkeqësitë natyrore, Integrohen masat e ndryshimit klimatik në politikat, strategjitë dhe planifikimin kombëtar, Përmirësohet edukimi, rritja e ndërgjegjësimit dhe e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale lidhur me zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen ndaj tyre, zvogëlimin e ndikimeve dhe paralajmërimin e hershëm, Përkrahen mekanizmat për ngritjen e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim efektiv lidhur me ndryshimet klimatike.

Në Kosovë, mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për të gjithë treguesit e këtij objektivi, prandaj zbatimi dhe monitorimi është i pamundur. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme, si psh.:

1. Numrin e vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur direkt që i atribuohen katastrofave,
2. Integrimi, adaptimi, ulja e ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm në kurrikulat e shkollave filllore, të mesme dhe terciare,
3. Forcimi i kapaciteteve institucionale, sistemike dhe individuale për të zbatuar adaptimin, zbutjen dhe transferimin e teknologjisë, dhe veprimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Tabela 15: OZhQ 13 – Veprim për klimën

Treguesit	2015	2016	2017	2018	2019
13.1.2 Numri i vendeve që adoptojnë dhe zbatojnë strategji kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat në përputhje me Kornizën Sendai për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive 2015-2030 ⁶⁸
13.2.1 Numri i vendeve që kanë komunikuar krijimin ose operacionalizimin e një politike / strategjie / plani të integruar i cili rrit aftësinë e shteteve për t'u përshtatur me ndikimet e pafavorshme të ndryshimit të klimës, dhe nxisin qëndrueshmërinë e klimës dhe zhvillimin e ulët të emetimeve të gazrave serrë në atë mënyrë që nuk dëmton prodhimin ushqimor ⁶⁹

⁶⁸ Ministria e Punëve të Brendshme, 2016. Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2016 – 2020. E qasshme në: https://mpb.rks-gov.net/Documents/SZRrF%20%20shqip_1.pdf

⁶⁹ Kosova që nga viti 2018 ka Strategjinë për ndryshimet klimatike 2019- 2028 dhe planin e veprimit për ndryshime klimatike 2019- 2021 E qasshme në: https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-13-59-04102018/SNK_PVnk_5%20tetor_2018_Finalë1ç.pdf

Nuk ka të dhëna për treguesin 13.1.2, por Kosova ka Strategji për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Planin e Veprimit 2016–2020 që është bazuar në kornizën Sendai 2015–2030. Sa i përket treguesit 13.2.1, Kosova ka strategjinë për ndryshimet klimatike dhe planin e veprimit për ndryshime klimatike. Njëjtë sikur edhe me strategjitë tjera, Kosova çalon në zbatim dhe monitorim. Nuk ka asnjë raport zyrtar se deri në çfarë mase janë zbatuar këto strategji apo ndonjë publikim të të dhënave relevante.



7.2 OZhQ 15 – Jeta nën ujë

Ky është objektivi 14 në Agjendën 2030, i cili ka gjithsej 10 qëllime dhe 10 tregues. Treguesit e këtij objektivi nuk ndërlidhen direkt me Kosovën duke pasur parasysh që Kosova nuk ka dalje në det. Sidoqoftë, Kosova duhet të ofrojë informata dhe fushata vetëdijesuese për kujdesin që duhet të bëjmë ndaj jetës nën ujë kur blejmë produkte ose hamë ushqim që vijnë nga oqeanet dhe të konsumojmë vetëm ato ushqime që na nevojiten, dhe të përdoren vetëm produktet e çertifikuara.

Ky objektivë është i rëndësishëm për të gjithë pasi që oqeanet ofrojnë burime natyrore kryesore përfshirë ushqimin, ilaçet, biokarburantet dhe produkte të tjera. Ato ndihmojnë në asgjësimin dhe largimin e mbeturinave dhe ndotjes dhe ekosistemet e tyre bregdetare veprojnë për të zvogëluar dëmtimet nga stuhitë. Mbajtja e oqeanëve të pastërta rrit përpjekjet për zbutjen dhe ndryshimet klimatike⁷⁰.

⁷⁰ Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, 2020. OZhQ-të, Objektiva 14.

E qasshme në: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals/goal-14-life-below-water.html>



7.3 OZhQ 15 – Jeta në Tokë

Ky është objektivi 15 në Agjendën 2030 i cili ka gjithsej 12 qëllime dhe 14 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, nuk ka të dhëna të plota për asnjë tregues, ndërsa ka dokumente strategjike për 1 tregues dhe të dhëna për vetëm 1 vit për 1 tregues tjetër nga gjithsej 14 tregues sa ka ky objektivi.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

Sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe i ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe shërbimet e tyre, veçanërisht pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata,

Promovohet zbatimi i menaxhimit të qëndrueshëm i të gjitha llojeve të pyjeve, ndalimi i shpyllëzimit, rehabilitimi i pyjeve të degraduar dhe rritja e qëndrueshme e pyllëzimit dhe ripyllëzimi në nivel global,

Luftohet shkretëtirëzimi, rehabilitimi i tokës së degraduar dhe të synohet ndalimi i degradimit të tokës,

Sigurohet ruajtja e ekosistemeve malore, përfshirë biodiversitetin e tyre,

Ndërmerren masa urgjente dhe të rëndësishme për të zvogëluar degradimin e habitateve natyrore, ndalimin e humbjes së biodiversitetit,

Ndërmerren veprime urgjente për t'i dhënë fund bllokimit dhe trafikimit të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës,

Vendosen masa për të parandaluar futjen dhe për të zvogëluar ndjeshëm ndikimin e specieve pushtuese të huaja në ekosistemet tokësore dhe ujore,

Përfshihen vlerat e ekosistemit dhe të biodiversitetit në planifikimin kombëtar, në proceset e zhvillimit, në strategjitë dhe raportimet për uljen e varfërisë,

Aktivizohen fondet nga të gjitha burimet dhe në të gjitha nivelet për të financuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Në Kosovë, mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për të gjithë treguesit e këtij objektivi, prandaj zbatimi dhe monitorimi është i pamundur. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme, si psh. përqindja e vendeve të rëndësishme për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla që janë të përfshira në zona të mbrojtura, progresi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, përqindja e tokës që është degraduar mbi sipërfaqen e përgjithshme të tokës, indeksi i maleve të gjelbërta, indeksi i listës së kuqe, përqindja e kafshëve të egra të tregtuara që ishte trafikuar, progresi drejt objektivave kombëtare në përputhje me traqetin 2 të "Aichi Biodiversity" të Planit Strategjik për Biodiversitetin 2011-2020, shuma e asistencës zyrtare për zhvillimin dhe shpenzimet publike për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe ekosistemeve.

Tabela 16: OZhQ 15 – Jeta në Tokë

Treguesit	2011	2012	2013	2017	2018	2019
15.1.1 Sipërfaqe pyjore si pjesë e sipërfaqes totale të Tokës ⁷¹		44.7
15.6.1 Numri i vendeve që kanë miratuar kornizat legislative, administrative dhe të politikave për të siguruar ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve ⁷²

Në Kosovë në vitin 2011 gjithsej kishte sipërfaqe pyjore 44.7%. Duke pasur parasysh që një pjesë e madhe e sipërfaqes është me pyje, Kosova ka probleme në veçanti në terrenet malore ku ka shkretëzim për shkak të erozionit të rëndë të tokës⁷³. Sipërfaqja me pyje në Kosovë është më e madh krahasuar me shtetet fqinje (Shqipëria 28%, Maqedonia 39%, Mali i Zi 40% dhe Serbia 31%). Megjithatë, cilësia e dobët dhe produktiviteti i pyjeve ekzistuese është shqetësuese, si rezultat i degradimit të vazhdueshëm të tyre. Ky degradim nuk mundëson ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore.

Sa i përket treguesit 15.6.1, në Kosovë ekziston Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetet 2011 – 2020. Qëllimi i kësaj strategjie është ruajtja (konzervimi) i biodiversitetit, zhvillimi i qëndrueshëm bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, krijimi i të hyrave dhe ndarja e përfitimeve nga shfrytëzimi i biodiversitetit në mënyrë të barabartë (kjo e fundit saktësisht siç kërkohet edhe nga treguesi i OZhQ-ve). Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna statistiko-re në mënyrë që të krahasohet ku qëndron Kosova ndër vite dhe në relacion me vendet tjera. Nuk ka asnjë raport zyrtar se deri në çfarë mase janë zbatuar objektivat e kësaj strategjie apo ndonjë raport me të dhëna relevante për këtë fushë.

71 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2020. Bujqësia në Figura dhe Shifra.

E qasshme në: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Bujqesia_ne_figura_dhe_shifra.pdf

72 Zyra e Kryeministrit, 2016. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetet 2011 – 2020.

E qasshme në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/09/SPVB-2016-2020-shqip.pdf>

73 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsiror, 2014. Strategjia për ndryshimet klimatike. E qasshme në: https://mmph.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Strategjia_p%C3%ABr_Ndryshimet_Klimatike_2014_2014_786565_688414.pdf

OZhQ-të në fushën e qeverisjes dhe bashkëpunimit

16 PEACE, JUSTICE
AND STRONG
INSTITUTIONS



17 PARTNERSHIPS
FOR THE GOALS



8

8. OZhQ-të në fushën e qeverisjes dhe bashkëpunimit

Fushat e qeverisjes dhe bashkëpunimit janë shumë të rëndësishme në Agjendën 2030. Paqja, drejtësia, dhe institucionet e forta janë të domosdoshme për të arritur OZhQ-të. Por, në Kosovë ende mbeten sfida të vazhdueshme, përfshirë ekonominë joformale, një gjyqësor të ngadaltë dhe joefikas, përhapjen e lartë të korrupsionit dhe institucionet e sundimit të ligjit të dobëta. Sa i përket të drejtave themelore, zbatimi i ligjeve dhe strategjive përkatëse vazhdon të jetë i ulët për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare dhe burime të tjera dhe mungesa e prioritetëve dhe koordinimit politik ⁷⁴. Njerëzit në gjithë botën nuk duhet të jenë të frikësuar nga dhuna dhe të ndjehen të sigurt, pavarësisht përkatësisë etnike, besimit ose orientimit seksual. Për të arritur progress në zbatimin e OZhQ-ve është shumë e rëndësishme të ketë institucione publike efektive dhe gjithëpërfshirëse që ofrojnë arsim cilësor dhe kujdes shëndetësor, politika të drejta ekonomike dhe mbrojtje gjithëpërfshirëse të mjedisit. Në të njëjtën kohë për të arritur OZhQ-të, bashkëpunimi në mes të institucioneve publike dhe shoqërisë civile, shkencëtarëve, akademisë dhe sektori privat është shumë e rëndësishme.

Qeverisja dhe bashkëpunimi adresohet nga 2 objektive në Agjendën 2030, siç janë:

Objektiva 16: Promovimi i shoqërive në paqe dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, siguria e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimi i institucioneve gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse, efektive në të gjitha nivelet,

Objektiva 17: Fuqizimi i mjeteve të zbatimit dhe të rigjallërimit të partneritetit global për një zhvillim të qëndrueshëm.

Në vijim janë të dhënat statistikore në dispozicion për treguesit që bien mbi secilën nga këto 2 objektiva të cilat adresojnë çështjet e qeverisjes dhe bashkëpunimit në Kosovë.

Tabela 17: Disponueshmëria e treguesve global në Kosovë në fushën e qeverisjes dhe bashkëpunimit

Çështjet e qeverisjes dhe bashkëpunimit	Numri i qëllimeve	Numri i treguesve	Tregues të disponueshëm sipas parimeve të Kombeve të Bashkuara	Tregues të përafërt	Tregues jo të disponueshëm
OZhQ 16 – PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA	12	23	1	3	19
OZhQ 17 – PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT	19	25	5	4	16
Total	31	48	6	7	35

Objektiva 16 ka gjithsej 12 qëllime dhe 23 tregues, mirëpo në Kosovë ka të dhëna vetëm për 1 tregues, ndërsa ka dokumente strategjike, por jo të dhëna statistikore për 3 tregues nga gjithsej 23 treguesit për këtë objektive. Objektiva 17 ka gjithsej 19 qëllime dhe 25 tregues, prej të cilëve ka të dhëna për 5 tregues, ndërsa ka dokumente strategjike për 4 tregues nga gjithsej 25 treguesit për këtë objektive.

74 Komisioni Evropian, 2019. Raporti për Vandin 2019.

E qasshme në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 23 tregues në objektivin 16.

8.1 OZhQ 16 – Paqe, drejtësi dhe institucione të forta

Ky është objektivi 16 në Agjendën 2030, që ka gjithsej 12 qëllime dhe 23 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, ka të dhëna vetëm për 1 tregues, ndërsa ka dokumente strategjike, por jo të dhëna statistikore për 3 tregues nga gjithsej 23 treguesit për këtë objektivë.

Qëllimet e këtij objektivi kërkojnë që të:

1. Zvogëlohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe numri i vdekjeve si rezultat i dhunës,
2. Përfundohen abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe të gjitha format e dhunës,
3. Promovohet sundimi i ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar,
4. Reduktohen ndjeshëm të hyrat e paligjshme financiare dhe të armëve dhe kthimin e pasurive të vjedhura dhe të luftoni të gjitha format e krimit të organizuar,
5. Zvogëlohen ndjeshëm korrupsioni dhe ryshfeti në të gjitha format e tyre,
6. Zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet,
7. Sigurohet vendimmarrje e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet,
8. Sigurohen të drejtat e publikut për të marrë informacion dhe të mbrohen liritë themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare,
9. Forcohen institucionet përkatëse kombëtare, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet për të parandaluar dhunën dhe luftuar terrorizmin dhe krimin,
10. Përkrahen dhe të forcohen ligjet dhe politikat jo diskriminuese për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Edhe pse ekzistojnë dokumente strategjike për këtë objektiv, në Kosovë mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për të gjithë treguesit e tij, prandaj zbatimi dhe monitorimi është i vështirë për tu bërë. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme, si psh.:

1. Përqindja e popullsisë që i nënshtrohet dhunës fizike, psikologjike ose seksuale,
2. Përqindja e popullsisë që ndjehen të sigurt duke ecur vetëm rreth zonës ku ata jetojnë,
3. Përqindja e fëmijëve të moshës 1-17 vjeç që pësuajnë ndonjë ndëshkim fizik dhe/ose agresion psikologjik nga ata që kujdesen për këta fëmijë,
4. Numri i viktimave të trafikimit njerëzor për 100,000 banorë,
5. Përqindja e viktimave të dhunës që raportuan viktimizimin e tyre tek autoritetet kompetente,
6. Numri i të arrestuarive të pa dënuar si një pjesë e popullsisë së përgjithshme që janë në burgje,
7. Vlera totale e të hyrave financiare të paligjshme për përqindjen e armëve të sekuestruara, të gjetura ose të dorëzuara,

8. Përqindja e personave apo bizneseve që kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik dhe që paguan ryshfet një zyrtari publik ose u kërkua ryshfet nga ata zyrtarë publik,

9. Përqindja e popullsisë që është e kënaqur me përvojën e tyre të fundit të shërbimeve publike,

10. Përqindja e popullsisë që beson se vendimmarrja është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme,

11. Të dhëna për numrin e rasteve të verifikuara të vrasjes, rrëmbimit, zhdukjes me forcë, ndalimit arbitrar dhe torturimit të gazetarëve, personelit të shoqëruar të mediave, sindikalistëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Tabela 18: OZhQ 16 – Paqe, drejtësi dhe institucione të forta ²

Treguesit	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
16.1.1 Numri i viktimave të vetëvrasjeve me paramendim për 100,000 banorë ⁷⁵	29	34	40	44	36	41	32	27	
Tregues i përafërt: për total banorë									
16.1.1.a Sipas gjinisë									
Burra			30	35	22	27	24	19	
Gra			10	9	14	14	8	8	
16.9.1 Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeç, lindjet e të cilëve janë regjistruar në një autoritet civil, sipas moshës ⁷⁶⁷⁷									
16.10.2 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë garanci kushtetuese, statute dhe / ose politika për qasje të publikut në informacion ⁷⁸
16.a.1 Ekzistimi i institucioneve të pavarura kombëtare për të drejtat e njeriut në përputhje me Parimet e Parisit ⁷⁹

75 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Vdekjeve për vitet 2011 deri 2018.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>

76 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Statistikat e Lindejeve.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/demografia-dhe-migracioni>

77 Agjencioni i Regjistrimit Civil, 2020. Lindja.

E qasshme në: <https://www.rks-gov.net/AL/f244/familja/lindja>

78 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2016. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

79 Institucioni i Avokatit të Popullit, 2020.

E qasshme në: <https://www.oik-rks.org/>

Sa i përket treguesit 16.1.1, nuk ka të dhëna për 100,000 banorë, por vetëm për numrin e përgjithshëm të viktimave të vetëvrasjeve me paramendim. Në vitin 2018 ishin 27 viktima, ky numër është më i ulët krahasuar me vitet paraprake ku numri më i lartë i viktimave ishte 44 në vitin 2014. Bazuar në të dhëna numri i viktimave burra është shumë më i lartë sesa numri i viktimave gra. Në vitin 2018 ishin 18 viktima burra, ndërsa 8 viktima gra, kjo diferencë ka qenë e ngjashme edhe në vitet paraprake.

Lindjet regjistrohen pothuajse 100% në Kosovë. Regjistrimi i lindjeve bëhet në afatin ligjor prej 30 ditëve nga dita e lindjes së fëmijës. Në raste të mosrespektimit të afateve ligjore për paraqitjen e lindjes apo lajmërimin të vdekjes, palët do të gjobiten në përputhje me ligjin.

Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë. Sa i përket treguesit 16.10.2, në Kushtetutën e Kosovës neni 41 E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike parasheh që secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike. Por, nuk kemi raporte zyrtare për të dhëna rreth qasjes në dokumente publike.

Sa i përket ekzistimit të institucioneve të pavarura kombëtare për të drejtat e njeriut, në Kosovë, Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, të cilat ligje, bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit përbëjnë pakon ligjore bazë të të drejtave të njeriut, e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015.



Mungojnë të dhëna sipas metodologjisë adekuate për 16 treguesit e objektivit 17.

8.2 OZhQ 17 – Partneritet për objektivat

Ky është objektivi 17 në Agjendën 2030 që ka gjithsej 19 qëllime dhe 25 tregues. Bazuar në burime të statistikave zyrtare në Kosovë, ka të dhëna për 5 tregues, ndërsa ka dokumente strategjike për 4 tregues nga gjithsej 25 treguesit e këtij objektivit.

Qëllimet e këtij objektivit ndahen në 7 fusha. Qëllimet e këtij objektivit në secilën fushë janë si më poshtë:

1. Fusha e financave kërkon që të forcohen:

- Mbledhjet e të hyrave burimeve të brendshme,
- Mbështetja nga vendet e zhvilluara për asistencë për zhvillim,
- Mobilizimi i burimeve shtesë financiare për vendet në zhvillim nga vendet e zhvilluara,
- Vendet në zhvillim në arritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit përmes politikave të koordinuara që synojnë nxitjen e financimit të borxhit, lehtësimin e borxhit dhe ristrukturimin e borxhit,
- Miratimi dhe zbatimi i regjimeve të promovimit të investimeve për vendet më pak të zhvilluara.

2. Fusha e teknologjisë kërkon që të:

- Përmirësohet bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar dhe qasja në shkencë, teknologji dhe inovacion,
- Promovohet zhvillimi, transferimi, dhe shpërndarja e teknologjive mjedisore për vendet në zhvillim me kushte të favorshme, përfshirë në kushte koncesionare dhe preferenciale,
- Funkcionalizohet plotësisht banka teknologjike dhe mekanizmin e krijimit të kapaciteteve të shkencës, teknologjisë dhe inovacionit për vendet më pak të zhvilluara, në veçanti teknologjia e informacionit dhe komunikimit.

3. Fusha e ngritjes së kapaciteteve kërkon që të:

- Rritet mbështetja ndërkombëtare për zbatimin e krijimit të kapaciteteve efektive në vendet në zhvillim për të mbështetur planet kombëtare për të zbatuar të gjitha OZhQ-të.

4. Fusha e tregtisë kërkon që të:

- Promovohet një sistem tregtar multilateral, të bazuar në rregulla, të hapura, jo-diskriminuese dhe të barabartë nën Organizatën Botërore të Tregtisë,
- Rriten ndjeshëm eksportet e vendeve në zhvillim, veçanërisht me synimin për të dyfishuar përqindjen e eksporteve globale në shtetet më pak të zhvilluara në deri në vitin 2020,
- Ofrohet qasje në treg pa kuota dhe pa tarifa për të gjitha vendet më pak të zhvilluara, në përputhje me vendimet e Organizatës Botërore të Tregtisë.

5. Fusha e çështjeve sistematike - Koherenca institucionale dhe politikave kërkon që të:
 - Rritet stabiliteti makroekonomik global, përfshirë përmes koordinimit të politikave dhe koherencës së politikave,
 - Rritet koherenca e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm,
 - Krijohen dhe zbatohen politika për zhdukjen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

6. Fusha e çështjeve sistematike - partneritete me shumë palë të interesuara kërkon që të:
 - Përmirësohet Partneritetin Global për Zhvillim të Qëndrueshëm që mobilizojnë dhe shkëmbejnë njohuri, ekspertizë, teknologji dhe burime financiare, për të mbështetur arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në të gjitha vendet, veçanërisht vendet në zhvillim,
 - Inkurajohen dhe promovohen partneritete efektive publike, publike-private dhe shoqëri civile.

7. Fusha e çështjeve sistematike - të dhënat, monitorimi dhe përgjegjshmëria kërkon që të:
 - Rritet mbështetja për krijimin e kapaciteteve për vendet në zhvillim dhe përfshirë vendet më pak të zhvilluara për të rritur në mënyrë të konsiderueshme disponueshmërinë e të dhënave me cilësi të lartë, në kohë dhe të besueshme, të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, përkatësisë etnike, statusit të migrimit, paaftësisë, vendndodhja gjeografike dhe karakteristikat e tjera të rëndësishme në kontekstet kombëtare,
 - Rriten iniciativat ekzistuese për të zhvilluar matje të progresit në zhvillimin e qëndrueshëm që komplementojnë BPV,
 - Mbështetet ngritja e kapaciteteve statistikore në vendet në zhvillim.

Në Kosovë, mungojnë të dhëna sipas metodologjisë ndërkombëtare për 16 tregues të këtij objekti. Mungojnë të dhëna shumë të rëndësishme për asistencën për zhvillimin, nuk ka të dhëna për shërbimin e borxhit si pjesë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, nuk ka të dhëna për numrin e marrëveshjeve dhe programeve të bashkëpunimit shkencor dhe/ose teknologji midis vendeve, sipas llojit të bashkëpunimit, mekanizma për të rritur koherencën e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm, vendet që raportojnë përparim në kornizat e monitorimit të efektivitetit të zhvillimit që mbështesin arritjen e OZhQ-ve. Nuk ka të dhëna për përqindjen e treguesve të zhvillimit të qëndrueshëm të prodhuar në nivelin kombëtar me ndarje të plotë kur është e rëndësishme për objektivin, në përputhje me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare. Nuk ka të dhëna për vlerën monetare në dollar për të gjitha burimet e vëna në dispozicion për të forcuar kapacitetin statistikor në vendet në zhvillim.

Tabela 19: OZhQ 17 – Partneritet për objektivat ³

Treguesit	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
17.1.1 Të hyrat totale të qeverisë si përqindje e BPV-së, sipas burimit të të hyrave ⁸⁰⁸¹	25.9	25	29.4	29.4	30.4	30.1	31.7
17.1.2 Përqindja e buxhetit vendor i financuar nga të hyrat tatimore ⁶⁴	80.5	84.8	82.7	83.0	79.5
17.3.2 Vëllimi i dërgesave/remiten-cave (në Euro) si përqindje e BPV-së totale ⁸²⁸³	11.9	12.87	13	11.4	12	12	12.2
17.6.2 Abonimet fikse në internet brezëgjërë për 100 banorë, sipas shpejtësi ⁸⁴⁸⁵	56.0	64.2	73.1	80.6	92.8
Përdoruesit e Internetit me Qasje Fikse (numër në mijëra)	167.9	190.8	215.8	239.4	274.7
Përdoruesit e Internetit (me qasje fikse dhe mobil) (numër në mijëra)	272.7	474.8	927.4	1362.2	1813.5
17.8.1 Përqindja e individëve që përdorin Internetin ⁸⁶⁸⁷		82.9	87.7	90.7
17.13.1 Paneli (dashboard) mak-roekonomik ⁸⁸							
17.18.2 Numri i vendeve që kanë legjislacion kombëtar statistikor në përputhje me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare ⁸⁹							
17.18.3 Numri i vendeve me një plan kombëtar statistikor që është plotësisht i financuar dhe në zbatim, sipas burimit të financimit ⁹⁰							
17.19.2 Përqindja e vendeve që (a) kanë kryer të paktën një regjistrim të popullsisë dhe strehimit në 10 vitet e fundit; dhe (b) kanë arritur 100% regjistrim të lindjes dhe 80% regjistrim të vdekjes ⁹¹							

80 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Llogaritë Kombëtare.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-kombetare-bpv>

81 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Llogaritë Qeveritare.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-qeveritare>

82 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Llogaritë Qeveritare.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-qeveritare>

83 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2019. Raporti Vjetor për vitet 2013 deri 2019.

E qasshme në: <https://www.bqk-kos.org/?id=102>

84 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Llogaritë Kombëtare.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-kombetare-bpv>

85 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, 2017. Raporti Vjetor 2017.

E qasshme në: <http://www.arkep-rks.org/repository/docs/Raporti%20Vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20ARKEP%202017.pdf>

86 Numri i familjeve që kanë qasje në internet brezëgjërë.

87 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2019.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5270/tik-2019.pdf>

88 Përdorimi i internetit nga individët 16-74

89 Ministria e Financave, 2019. Buletini Makroekonomik.

E qasshme në: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,32>

90 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Ligji për Statistikat Zyrtare.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/legjislacioni>

91 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2020 dhe Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022.

E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/fund-faqe/planet-dhe-raportet>

Të hyrat totale të Qeverisë si përqindje e BPV-së janë rritur ndër vite. Të hyrat totale në vitin 2019 ishin 31.7% e BPV-së. Rritje drastike u regjistrua në vitin 2015 me 29.4% nga 25% sa ishte në vitin paraprak. Të hyrat totale përfshijnë tatimet, grante dhe kontributet sociale. Të hyrat tatimore janë financuesit kryesorë të buxhetit vendor me rreth 80%, saktësisht në vitin 2019 buxheti i financuar nga të hyrat tatimore ishte 79.5%, 3.5% më pak se sa në vitin paraprak. Financimi përmes të hyrave totale është zvogëluar në vitin 2019 pasi që është rritur financimi i buxhetit nga resurse tjera ose nga kreditë.

Përqindja e remitencave si pjesë e BPV në vitin 2019 ishte 12.2%, ngjashëm ishte edhe në vitet paraprake. Remitencat e pranuar në Kosovë, njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen rreth 40% ose përkatësisht 21% të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht rreth 6.5% e gjithsej remitencave.

Sa i përket qasjes në internet brezëgjërë, në Kosovë në vitin 2017 qasje në internet kishin 92.8% të familjeve. Bazuar në të dhënat e tabelës 17, përdoruesit e Internetit (me qasje fikse dhe mobil) është dyfishuar nga viti 2015 deri në vitin 2017. Kjo rritje kryesisht i është atribuar përdoruesve të internetit me qasje me mobil. Fatkeqësisht, ARKEP nuk ka publikuar të dhënat për vitet 2018 dhe 2019. Përqindja e individëve që përdorin Internetin në Kosovë është e lartë. Bazuar në të dhënat në tabelën 14, 90.7% e individëve të moshës 16-74 vjeç kanë përdorur internetin. Sa i përket treguesit 17.13.1, Ministra e Financave dhe Transfereve përgatitë Buletin Makroekonomik në baza tremujore.

Kosova e ka legjislacion kombëtar statistikor pjesërisht në përputhje me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare, ligji bazë i statistikave është Ligji për Statistikat Zyrtare. ASK gjithashtu ka të miratuar planin vjetor të statistikave zyrtare 2020 si dhe Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022. Regjistrimi i popullsisë është mbajtur në vitin 2011 në Kosovë dhe pritet të mbahet përsëri në vitin 2021. Regjistrimi i lindjeve dhe vdekjeve është i plotë.

9. Përfundimet

Sikur të gjitha vendet e botës, edhe Kosova nuk ka rrugë tjetër përveç se të punojë zellshëm që të avancoj agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm përveç në Agjendën 2030 është i rëndësishëm edhe në politikën evropiane ku zhvillimi i qëndrueshëm është i përfshirë në traktate. Kjo agjendë e vitit 2030 ka 17 objektiva, 169 qëllime (targets) dhe 232 tregues unik.

Në mënyrë që objektivat dhe treguesit të monitorohen nga të gjitha shtetet e botës është zhvilluar korniza globale e treguesve nga OKB në mënyrë që të dhënat dhe treguesit të mund të krahasohen mes vendeve. Fatkeqësisht, Kosova ende nuk e ka krijuar një kornizë të monitorimit, por ky punim nxjerr në pah zbatimin e treguesve të OZhQ-ve, duke u bazuar në të dhënat zyrtare në dispozicion.

Numri më i lartë i treguesve që kanë të dhëna të disponueshme është në fushën e zhvillimit ekonomik, ku janë gjithsej 10 tregues të kalkuluar sipas metodologjisë adekuate nga gjithsej 56 tregues për këtë fushë. Në fushën e zhvillimit të infrastrukturës dhe inovacionit ka të dhëna për 6 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 6 tregues ku të dhënat janë pjesërisht në harmoni me metodologjinë ndërkombëtare nga gjithsej 44 tregues për këtë fushë.

Sa i përket çështjeve sociale, të dhënat janë në dispozicion për 8 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 13 tregues ku të dhënat janë pjesërisht në harmoni me metodologjinë ndërkombëtare nga gjithsej 62 tregues për këtë fushë. Në fushat e qeverisjes dhe bashkëpunimit ka të dhëna në dispozicion për 6 tregues sipas metodologjisë adekuate dhe 7 tregues ku ka vetëm dokumente strategjike, por jo edhe monitorimi i tyre nga gjithsej 48 tregues për këtë fushë.

Përkundër faktit që mjedisi është thelbësor për zhvillim dhe zbatim të Agjendës 2030, fusha e çështjeve mjedisore ka më së paku të dhëna në dispozicion. Kjo fushë ka të dhëna vetëm për 4 tregues, të cilët nuk janë kalkuluar duke përdorur metodologjinë adekuate. Të dhënat për disa tregues që nuk përdorin metodologjinë ndërkombëtare mund të përdoren për krahasim ndër vite vetëm brenda vendit, por jo për krahasime me vendet tjera.

Monitorim i zbatimit të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm ende mbetet një sfidë për Kosovën, duke pasur parasysh që disponueshmëria e të dhënave zyrtare është e ulët. Gjithashu, ka vonesa në publikimin e të dhënave deri dy vite p.sh. në vitin 2020 ka të dhëna vetëm për vitet 2017 ose më herët. Sipas raporteve ndërkombëtare, Kosova në fushën e statistikave ende ballafaqohet me resurse financiare dhe kapacitete njerëzore të pamjaftueshme. Kjo reflektohet edhe në të dhënat në dispozicion që janë relevante për monitorimin e treguesve të Agjendës 2030.

10. Rekomandime

- 1) Agjencia e Statistikave të Kosovës të përforcojë rolin e vet bashkërendues në Sistemin Kombëtar Statistikor. Duhet të rritet alokimi i buxheti për Agjensionin e Statistikave të Kosovës për prodhimin e statistikave dhe të fuqizohen kapacitetet njerëzore specifikisht në kalkulimin dhe monitorimin e treguesve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm brenda Agjensionit të Statistikave. Të themelohet apo caktohet një njësi e veçantë përbrenda ASK-së për zhvillim të qëndrueshëm për të koordinuar departamentet e ndryshme statistikore brenda sistemit statistikor për të mbledhur të dhëna për OZhQ-të.
- 2) Të fillojë monitorimi i treguesve të OZhQ-ve sipas treguesve relevant për Kosovën duke përfshirë priorizimin e tyre nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (si bazë për të filluar monitorimi mund të përdoret ky punim) dhe të përgatitet raporti në baza të rregullta vjetore për zbatimin e OZhQ-ve në Kosovë.
- 3) Agjencia e Statistikave të Kosovës të sigurojë cilësinë e të dhënave duke bërë një vlerësim të përputhshmërisë me standarde ndërkombëtare të të dhënave që prodhohen nga të gjitha institucionet në Kosovë.
- 4) Të integrohen tregues specifik të OZhQ-ve në strategjinë kombëtare për zhvillim dhe në strategjitë sektoriale. Këto strategji duhet të shoqërohen me plane veprimi që vendosin indikatorët e zhvillimit të qëndrueshëm si matës të zbatimit të strategjive.
- 5) Të forcohet mbikëqyrja e Kuvendit mbi zbatimin dhe monitorimin e OZhQ-ve. Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm brenda Kuvendit duhet të organizojë dëgjime publike dhe të fuqizojë rolin e vet mbikëqyrës ndaj Qeverisë dhe institucioneve të tjera në funksion të zbatimit të OZhQ-ve.
- 6) Të rritet gama e ofrimit të të dhënave për të gjithë sektorët që mbulojnë treguesit e OZhQ-ve, e sidomos për treguesit për mjedisin, çështjet sociale dhe inovacionin.
- 7) Të rritet bashkëpunimi në mes të institucioneve publike dhe shoqërisë civile, akademisë dhe sektori privat. Të miratohet një Strategji për Financimin Publik të OJQ-ve në të cilën do t'u jipet prioritet projekteve që zbatojnë dhe avancojnë OZhQ-të dhe rrisin vetëdijësimin e qytetarëve përmes shpërndarjes së informacioneve, si grafikëve, posterave, mediave sociale etj.
- 8) Komunat e Kosovës duhet të përfshihen në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në lidhje me progresin në zbatimin e OZhQ-ve.
- 9) Të rritet përdorimi i regjistrave administrative si një burim i rëndësishëm i të dhënave për monitorimin e OZhQ-ve dhe të rritet disponueshmëria e këtyre të dhënave.
- 10) Të digjitalizohet mbledhja e të dhënave statistikore duke kontribuar në kost-efektivitet.

